

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7782 E diel 3 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
P'o t'i heqim shumës së të gjitha koncesioneve të dhëna me formulën Partneritet Publik-Privat, atë të rrugës Thumanë-Vorë (45 miliardë lekë të reja ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Pse më fut dorën në xhep për 15 vjet, qeveri?


Opinion *i* **Ditës**
Duke ndjekur, pa shumë vëmendje, por pa dyshim, me një lloj kurioziteti të holluar debatet e shqiptarëve në internet, qëlloi të ndeshja emrin dhe adresën ...
Vijon në faqen 22

Nga BLENDI FEVZIU
Identiteti "made in Albania"




Policia: Akuza për falsifikim dokumentesh
Trafiku, çonin njerëz në SHBA e Kanada për 20 mijë euro, 32 veta në pranga

Operacioni/ Grupi i organizuar dërgonte persona të ndryshëm për 10 mijë paund në Angli, 4 në kërkim
Trafiku u klandestinëve nga Shqipëria me destinacion vendet e BE-së dhe SHBA-të ka çuar në pranga 32 persona, mes të cilëve edhe një efektiv policie. Megaoperacioni i koduar "Rruga e gabuar" u finalizua nga Policia e Shtetit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ky operacion ...
Në faqen 5

30 MIJE APARTAMENTE NE PRITJE TE LEGALIZIMIT, JA SI DO BEHET PROCESI 1300 PALLATE PA HIPOTEKE, ARTAN LAME: SI MERRET LEJA

Kreu i ALUIZNI-t fton banorët të aplikojnë për legalizim dhe regjistrim të pasurisë, kur kanë shtesa pa leje ose pronari ka ndërtuar me shkelje



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

DIPLOMACI
Replika Cakaj-Daçiq në Bukuresht për prejardhjen kosovare, ironizon Ylli Manjani
Në faqen 4

"BURSAT, VENDOS QEVERIA"
Edi Rama, apel studentëve: Po rrezikoni vitin, kaq 'pula' jeni?
Në faqen 3

OPOZITA
Basha në Ballsh: Pushtetarët e korruptuar do t'i çojmë në burg
Në faqen 2

KRIMI NE TIRANE
Vrasja e Devi Kasmit, prokuroria: Prova filmike që 'gozhdon' grekun Eftimiu
Në faqen 8

"MILOSAO"

Historia e Konstandinit të legjendës, e vërteta e madhe
Suplement

EMRAT/ Profesionistët e shëndetësisë që kualifikohen për një vend pune
Lista e dytë, 660 infermierët fitues në portal
Kalendari, datat dhe oraret për fazën tjetër në Tiranë dhe në rrethe

NGA VOLTIZA DURO
Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listat e fituesve për qarkun



e Tiranës si dhe datat e testimit të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë. Përkatesisht janë 357 fitues në këtë qark për Infermierinë, 81 fitues për pozicionin mami, 57 fitues në Teknik Imazherie, 80 fitues për pozicionin Teknik Laboratori dhe 89 fitues ...
Në faqen 10-11

PROTESTAT THIRRJA

Kreu i PD-së, në bastionin e së majtës: Zgjidhim hallet e naftëtarëve

Basha në Ballsh: Pushtetarët e korruptuar do t'i çojmë në burg

"Më 16 shkurt merr fund kontrata me Ramën"

Valentina Madani

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, u zhvendos dje në Mallakastër, në bastionin e së majtës, ku takoi nga afër qytetarët, të cilëve u bëri thirrje që t'i bashkohen protestës më 16 shkurt në Tiranë. Sipas tij, ky aksion do të largojë Edi Ramën nga zyra kryeministrale. Vizita e kryetarit të opozitës, Lulzim Basha, në qytetin e Ballshit gjeti mbështetjen e shumë qytetarëve, të cilët iu bashkuan aktivitetit të PD-së. Madje, Lulzim Basha hasi vështrësi të kalonte mes turmës. Teksa shtrëngoi duart me ta, banorëve të këtij qyteti, të cilët bashkëjetojnë me naftën, z.Basha iu premtoi heqjen e taksës së karburantit që shqiptarët e paguajnë të çdo litër karburant që blejnë kur të vijë në pushtet. Qytetarët me të cilët bashkëbisedoi u anjuan për keqeverisje dhe mospërmbyshje të premtimeve nga qeveria, por edhe mungesën e mbështetjes nga politika në përgjithësi. Basha premtonte se do të vendoset në krye të protestës në 16 shkurt, ndërsa shqiptarët, sipas tij, duhet të marrin vetë në dorë dinamikën e saj. Basha bashkëbisedoi me një naftëtar, i cili udhëtoi 140 km nga Ballshi në Tiranë në këmbë për të kërkuar të drejtën e tij, por edhe të naftëtarëve, të cilët kanë shumë probleme, mbi të gjitha sa i takon statusit të naftëtarit. Ai i tha kreut të opozitës se Rama gënjeu 1 mijë punëtorë dhe u tha, "do t'ju jap lekët" dhe nuk u ka dhënë asnjë qindarkë. Basha iu përgjigj shqetësimit të ballshiotëve me të cilët u takua. "Tani është në dorën e popullit. Është në dorën tuaj. Ju e dini fare mirë se çfarë i ka bërë lekët Rama. Lekët i ka ndarë me njerëzit e tij. Nafta nuk ka sjellë asgjë të mirë për ju, por vetëm përfitim me miliona euro për pushtetin e Edi Ramës. Edi Rama premtoi rritjen e pensioneve. Sapo takova disa pensionistë, të cilët më thanë se nuk u mjafton as për të blerë ilaçet dhe as faturën e energjisë. Në çdo gjë që konsumoni, kosto e lartë përfshin



Kreu i PD-së dje me banorët e Ballshit

PREMTIMI

"PD nesër në pushtet nuk do të mjaftohet me konfiskimin e pasurive të të gjithë zyrtarëve dhe oligarkëve që abuzuan me paratë dhe mundin tuaj. Ne do t'i çojmë ata para drejtësisë. Ligji do t'i dënojë, do t'i çojë ata në burg dhe jo qytetarët e pafajshëm, që luftojnë për mbijetesë. Që kjo të ndodhë, duhet të kthejmë zgjedhjet e lira. PD dhe opozita e kanë paraqitur zgjidhjen politike, një qeveri kalimtare", tha z.Basha.

"Qeveria hajdute rrëzohet me demonstrata"

Shehi: Nga protesta do të varet edhe fati i zgjedhjeve

Alëati i PD-së, kreu i ALZHK-së, Dashamir Shehi, deklaroi dje në "News 24" se nga protesta e 16 shkurtit do të varet dhe fati i zgjedhjeve. Kryetari i LZHK u shpreh se opozita kërkon që të ketë një klimë të re dhe të zhvillohen zgjedhjet, pasi me këtë klimë sipas tij nuk ka zgjidhje të lirë dhe të ndershme. "Sigurisht që varet edhe fati i zgjedhjeve. Ne duam që zgjedhjet të bëhen të ndershme dhe me një klimë të mirë. Të bëhen nga një qeveri që është e mbështetur nga të gjitha partitë, e mbështetur nga të gjitha. Duhet një klimë e re, nëse sot qeveria thotë se ka 20 banda, ne themi 10 banda, t'i asgjësojë. Nëse themi



që ka oligarkë që futin dorën tek xhepat tanë, qeveria t'i shikojë dhe të anulojë projektet. Duhet rrezimi i këtij me demonstrata, të zgjidhet një tjetër dhe pastaj zgjedhje për të gjithë shqiptarët, le ta votojnë prapë shqiptarët", deklaroi Shehi. Ai foli edhe për gjuhën e shthurur dhe jo etikë në Kuvend që agravoji të en-

jten e fundit. Shehi tha se debati nuk ishte i lejueshëm, por për këtë gjë bën fajtor Edi Ramën, pasi sipas tij, ai është përfaqësues i të gjithëve. "Atë ditë është agravuar situata dhe kjo është derivat i një situatë që ka ardhur duke u majsuar. Siç thotë populli, zullumi këputet duke u trashur. Fajtori i kësaj punë është Edi Rama. Rama me ironinë e tij, por që dhe Berisha ka faj që i përgjigjet, edhe pse është opozitar. Berisha përgjegjësinë e ka individuale, ai është kryeministër, na përfaqëson edhe në që jemi kundërshtarë i tij. Ai i ngacmon të gjithë, edhe atë më të urtin", u shpreh Shehi.

naftës, por nafta nuk ka sjellë asgjë të mirë në familjet tuaja. Përkundrazi, duhet ta paguajnë me çmimin më të lartë edhe ata që nuk kanë autotomjet. Kjo ndikon drejtpërdrejt në çmimin e ushqimeve, mishit, perimeve, bukës. Kjo, sepse Edi Rama i ka shtuar taksë naftës prej 300 lekësh për litër. Kanë përfitim me miliona euro me naftën e Ballshit", deklaroi z.Basha. Kreu i demokratit u bëri thirrje qytetarëve mallakastriotë që të mos e braktisin vendin, por të bashkohen për të rrezuar qeverinë. Z.Basha i garantoi ata se PD sapo të vijë në pushtet, do t'i dorëzojë drejtësisë



SHKURT

Banorët bllokojnë rrugën në Burrel: Qeveria po na varfëron

Rritja e çmimeve, papunësia, largimi i të rinjve jashtë vendit, falimentimi i bizneseve dhe infrastruktura e munguar janë motivet që shtynë dje banorët të Burrelit të protestonin. Me pankarta në duar ku lexohej "Bizneset po falimentojnë çdo ditë" apo "qeveria po na varfëron", banorët marshuan për 30 minuta në këmbë në shenjë proteste në kryqëzimin e Urës së Matit, duke bllokuar kështu aksin kombëtar. Në mbështetje të protestuesve ishin edhe deputet të Partisë Demokratike. Në fund protesta u shpërnd në mënyrë paqësore, ndërsa për normalizimin e qarkullimit ndërhyrën efektivet e policisë, që e ndoqën protestën nga afër. PD po zhvillon protesta lokale, të cilat i paraprinë protestës së madhe në Tiranë më 16 shkurt.

PDIU pa anëtarë KZAZ-je, ankimon në Kolegj Zgjedhor vendimin e KQZ-së

KQZ-ja ka nisur punën me Kodin e vjetër Zgjedhor edhe pse në Kuvend ndodhet një draft i ri, në prirje të konsensusit mazhorancë-opozitë. Përplasja e parë e këtij institucioni me forcat politike u ciklura në mbledhjen e fundit, ku u ndanë anëtarët e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhjeve. PDIU pretendon përfaqësi në këto organe, ndaj burimet theksuan se javën e ardhshme kjo forcë politike pritet të ankimojë KQZ-në në Kolegjin Zgjedhor, duke e vënë në lëvizje këtë organ pas shumë muajsh pushim. Kolegji Zgjedhor u zgjodh me short nga KLD në dhjetor të vitit 2016, ndërsa po e njëjta trup do të angazhohet edhe për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Gjyqtarë në Kolegjin

pushtetarët e korruptuar. "Dua ta them fare qartë, Partia Demokratike nesër në pushtet nuk do të mjaftohet me konfiskimin e pasurive të gjithë zyrtarëve dhe oligarkëve që kanë abuzuar me paratë, djersën dhe mundin tuaj. Ne do t'i çojmë ata para drejtësisë. Ligji do t'i dënojë, do t'i çojë ata në burg dhe jo qytetarët e pafajshëm, që luftojnë për mbijetesë", tha Basha.



Kryeministri me studentët: Kaq 'pula' jeni?! Prisi t'ju shpëtojë 'gjeli' nga Kryeministria

Rama, apel studentëve: Po rrezikoni të humbisni vitin akademik

"Bursat, tashmë në dorë të qeverisë"

Kryeministri Edi Rama u kërkoi studentëve t'u rikthehen sa më parë auditorëve, pasi rrezikojnë të humbasin vitin akademik. Rama zhvilloi dje një bashkëbisedim me studentët në sallën e re të rikonstruktuar të studimit tek Konvikti e Mjekësisë. Kryeministri u bëri apel studentëve që të shkojnë në mësim, pasi në të kundërt do humbasim mësimin. "Tani kaq të drejta i keni marrë nga qeveria, ç'jeni ju, pula jeni. Do ju digjet viti se e kam dëgjuar edhe teorinë që do shtyhet viti, do rrinë studentët mullar të dera, ata të tjerët që do vijnë, s'do ketë vende dhe do nisë një jetë e re. Nëse do kishit dalë në protestë para dy vitesh, do ju thosha të drejtë keni, por nuk bëhet. Sot e kemi mundësinë", deklaroi z.Rama. Kryeministri nuk kurseu kritikën për pedagogët dhe rektorin e Universitetit të Tiranës. Duke iu referuar situatës në disa fakultete, ku mësimi është bllokuar nga një pjesë e studentëve, Rama u kërkoi studentëve t'i kërkojnë llogari rektorit për situatën e krijuar. Sipas kryeministrit, rektori merr pagë edhe nga 13 borde dhe duhet të garantojë mësimin. "I shkoni në shtëpi rektorit dhe i thoni dil jashtë, se merr paga edhe nga 13 borde, dil jashtë dhe hajde këtu, më hap universitetin të marr dokumentet për bursat. Shkoni rrini atje të dera e universitetit. Nëse e kërkoni këtë nga unë dhe nga qeveria, e kërkoni në derën e gabuar, pasi nuk mund të fusim policinë nëse nuk e kërkoni rektori. Po me çfarë merret rektori, nëse nuk garanton mësimin? Çfarë borxhi kanë prindërit që të humbasë fëmija vitin dhe të presë që të hapet dera. Unë vij me ju, por mblidhuni atje. Ne shkuam atje, por na thonë se jeni të FRESH-it", - tha Rama.



Kryeministri Edi Rama dje me studentët e Mjekësisë

THIRRJA
"Do ju digjet viti, se e kam dëgjuar edhe teorinë që do rrinë studentët mullar të dera, ata të tjerët që do vijnë s'do ketë vende dhe do nisë një jetë e re. Nëse do kishit dalë në proteste para dy vitesh, do t'ju thosha të drejtë keni, por nuk bëhet". Sot e kemi mundësinë", deklaroi z.Rama.

DEKLARATA

"Si mund të rrini si pula që prisi që të vijë gjeli nga Kryeministria t'ju shpëtojë?! Unë vij me ju të hap derën. A e dini se pse bëhet konflikti mes dekanit dhe bordeve? Për tenderat, për rojet, paguajmë një mal me lekë. Janë roje të panevojshme, të padobishme dhe marrin një mal me para. Universitetet duhet të kenë rojet e tyre", tha Rama.

Berisha denoncon skandalin: Përdhuhet nxënësja, fshihet krimi

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje një krim të tmerrshëm, sipas tij dhe mesazheve të qytetarëve dixhitalë, të ndodhur në Kavajë. Bëhet fjalë për përdhunimin e një nxënëseje të shkollës 9-vjeçare nga 8 nxënës të po të njëjtës shkollë. Berisha shkruan se ndaj përdhunuesve nuk merret asnjë. "Përdhuhet nxënësja, fshihet krimi! Ndaj përdhunuesve nuk merret asnjë masë, anëtarësohen në FRESH-in kanabist", shprehet Berisha. Ai zbardhi mesazhin e qytetarit dixhital: "Jam një zonjë nga Kavaja. Dua të denoncoj mënyrën flagrante se si drejton sot ZA e Kavajës zonja Sonila Peza. Prej 2 muajsh në shkollën 9-vjeçare 'Rilindja', 8 nxënës të asaj shkolle kanë përdhunuar një vajzë. ZA dhe drejtoresha e saj nuk kanë marrë asnjë masë për këtë skandal. Kemi frikë të çojmë fëmijët në shkollë. Këto janë drejtoreshat e shkollave të rilindjes". "Përsëritet doktor Berisha. Në shkollën 9-vjeçare 'Rilindja', Kavajë, përpara 1 muaji u përdhunua nga një grup prej 8 djemsh një vajzë 13-vjeçare. Kjo ngjarje është mbajtur e fshehtë nga të gjitha instancat. I gjithë qyteti e di".



"Edi Rama, edhe ministër i Arsimit"

Pakti për Universitetin, LSI: Pazar në kurriz të shqiptarëve

Deputetja e LSI, Kejdi Mehmetaj, akuzoi dje se kryeministri Edi Rama po shkatërron universitetin. Mehmetaj e cilësoi shfaqje të shëmtuar takimin e Ramës me studentët e Mjekësisë. Sipas saj, i ashtuquajtur Pakti për Universitetin, i propozuar nga qeveria është një pazar në kurriz të shqiptarëve. Duke iu referuar mungesës së ministres së Arsimit gjatë një takimi që zhvilloi Rama me studentët e Mjekësisë, Kejdi Mehmetaj shprehet se sot do të ishte tani për ministër Ar-



simit nuk kemi më Besa Shahunin, por bedelin e saj, ose e thënë me qartë zëvendësuesin e saj, Edi Ramën. "Kjo u pa në takimin e sotëm, (djeshëm)

ku ministresha mungonte dhe me një grusht të vogël studentësh të Mjekësisë përkundrejt mijëra të tjerëve që studiojnë në atë fakultet, Edi Rama tregoi që në të vërtetë Pakti për Universitetin është pazar për universitetin. Një pazar i rëndë në kurriz të shqiptarëve që trembet nga transparenca dhe nga kamerat. Pakti për Universitetin është në të vërtetë pazar universitetin që shtet studentët dhe pedagogët për interesat e Edi Ramës", - tha Mehmetaj.

teorinë që do shtyhet viti do rrinë studentët mullar të dera, ata të tjerët që do vinë s'do ketë vende dhe do nisë një jetë e re. Nëse do kishit dalë në protestë para dy vitesh, do ju thosha të drejtë keni, por nuk bëhet. Sot e kemi mundësinë. Ju të pranoi që një grusht njerëzish atje, dhe një grusht pedagogësh t'ju kërcënojnë në këtë farë feje dhe t'ju kompleksojnë, jo jeni tradhtarë... Jo grevëthyes... e të mos mblidhni bashkë, jo për t'u zënë e kacafytur, por për të qëndruar të dera dhe për të kërkuar llogari deri kur të hapet dera. Për t'i shkuar në shtëpi të rektorit dhe për t'i thënë dil jashtë nga shtëpia e hajde më hap universitetin. Unë të mos marr bursën sepse ti do të

bllokohet universitetin për Saliun, Lulin, Monikën... Ç'më duhet mua?! Nuk keni për të marrë dot bursat, s'keni për të marrë asnjë lekë. Dokumentet do i sjellin ata. Si mund të rrini si pula që prisi që të vijë gjeli nga Kryeministria t'ju shpëtojë?! Unë vij me ju të hap derën. Por jo... ne shkuam atje, por na thonë ju jeni të FRESH. Jo! Më intereson

mua se çfarë thonë këta... jo u vesha me atlete, jo për pantallonë... pse për këta jetojmë?!", deklaroi z.Rama. Pasi dëgjoi ankesat e studentëve për kushtet në konvikte, kryeministri përsëriti angazhimin për rikonstruksionin e tyre dhe ndërtimin e kampusit universitar, ndërsa nuk la pa akuzuar zbatuesit e oborreve të godinave.

Shoqëria "Rojen 03" shpk
ka importuar Cigaren me te re nga Spanja **Desert Blue** and **Desert Red** me çmim 250 LEK"

DIPLOMACIA PËRPLASJA

Takimi dyditor në Bukuresht, ministri shqiptar i kujton homologut serb origjinën

Valentina Madani

Vizita e parë e Gent Cakaj si ministër i Jashtëm i Shqipërisë nisi me shigjetime për shefin e diplomacisë shqiptare. Ai mori pjesë në Samitin e Ministrave të Jashtëm të BE-së dhe vendeve të Ballkanit, që u zhvillua në Bukuresht, në kuadër të presidencës rumune të Këshillit të Ministrave të BE-së. Por Cakaj është përballur me një situatë befusuese nga ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, i cili nuk ka mundur të mos e shigjetojë zv.ministrin shqiptar që vjen nga Kosova. Meqenëse në takim përveç tij ishte dhe ministri i Jashtëm i Kosovës, Behxhet Pacolli, Dačić kërkoi shkas për ta parë këtë si provokim, duke e nisur takimin me shigjetime. Në përpjekje për të vënë në pozita të vështira Cakajn përballë liderëve europianë, Dačić nuk e fshehu shqetësimin përse Kosova ka dy ministra të Jashtëm në tryezë, ndërkohë që ministri Cakaj i kujtoi origjinën nga Prizreni. "Përse Kosova ka dy ministra të Jashtëm në tryezë? Ky është një provokim i rëndë që na bëhet nga ministri i Jashtëm, Edi Rama", tha z.Daçiç. Por, këto provokime nuk e kanë gjetur të papërgatitur ministrin e Jashtëm shqiptar, i cili nuk vonoi t'i kundërpërgjigjet homologut të tij. Cakaj nuk ia la mangët dhe i ka kthyer një përgjigje të shpejtë Dačićit, që ka shkaktuar ilaritet në sallë. Nisur nga fakti që Dačić është nga Prizreni, ministri Cakaj i kujtoi se duhej të ishte skandalizuar më herët. "Në fakt, z.ministër ju duhet të ishit skandalizuar më parë, sepse Kosova i ka pasur dy dhe ka një fjalë që thotë, nuk ka dy, pa tre! Ju jeni nga Prizreni apo jo, por përfaqësoni këtu Serbinë, ndërsa unë po, jam shqiptar nga Kosova dhe përfaqësoj Shqipërinë". - i tha Cakaj Dačićit. Me gjasë, përgjigja flakë për flakë e kryediplomatit shqiptar e ka bërë të reflektojë gjatë Dačićin, i cili për pak sa nuk humbi edhe foton e rastit. Ministri Cakaj në Bukuresht zhvilloi takime me disa homologë, ku theksi u vu te detyrat që i janë lënë Shqipërisë deri në hapjen e negociatave. Ministri në detyrë Cakaj, pasi vlerësoi mbështetjen e vendeve anëtare të BE-së në rrugën e integritimit evropian të Shqipërisë, vuri në dukje

Replika për përfaqësimin në Rumani, Cakaj përplaset me Dačić

Dačić: Kosova, me 2 ministra. Cakaj: Je nga Prizreni



Ministri i Jashtëm Gent Cakaj dhe zv.ministër i Jashtëm i Rumani në Samitin e Bukureshtit

Numri i ministrave të Jashtëm të Kosovës

Debati Cakaj-Dačić, Manjani: Vetëm Shqipëria s'paska pasur ministër

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani komentoi dje replikat mes ministrave të Jashtëm të deleguar, Gent Cakaj dhe ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivica Dačić në Bukuresht, në samitin e BE për Ballkanin. Manjani e shikon si "shumë interesant" debatin, por thotë se në këtë lojë kungulleshkash vetëm Shqipëria nuk paska pasur ministër. "Shumë interesant ky debati në Rumani për numrin e ministrave të Jashtëm të Kosovës. Dačić ka thënë se Kosova përfaqësohej në tryezë nga dy ministra të Jashtëm (Pacolli dhe Cakaj). Gent Caka ka thënë se janë 3 bashkë me vetë Dačić, i cili qenka nga Prizreni. Në këtë kungulleshë, vetëm Republika e Shqipërisë nuk paska pas ministër aty". Në samitin e BE për Ballkanin. Në viz-



itën e parë pas delegimit të kompetencave për ushtrimin e detyrës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtëm, Gent Cakaj mori pjesë në takimin e ministrave të Punëve të Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve kandidatë, i cili u zhvillua në Bukuresht më 31

janar-1 shkurt, në kuadër të presidencës rumune të Këshillit të Ministrave të BE-së. Diskutimet u përqendruan në çështjet kryesore të axhendës evropiane dhe ndërkombëtare, sfidat e përbashkëta dhe bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.

bisedimet e anëtarësimit të jenë njohje e arritjeve dhe mekanizëm për orientimin e tyre të ardhshëm. Ai evidentoi gjithashtu rolin proaktiv e konstruktiv

të Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon, duke shprehur se në aspektin global, vendi ynë dëshmon me vendosmëri orientimin e tij strategjik euroatlantik

GENTI CAKAJ

"Në fakt, zoti ministër, ju duhet të ishit skandalizuar më parë, sepse Kosova i ka pasur dy, dhe ka një fjalë që thotë nuk ka dy pa tre! Ju jeni nga Prizreni apo jo, por përfaqësoni këtu Serbinë, ndërsa unë, po, jam shqiptar nga Kosova dhe përfaqësoj Shqipërinë!", i tha Cakaj Dačićit.

IVICA DAČIĆ

Në përpjekje për të vënë në pozita të vështira Cakajn përballë liderëve europianë, Dačić pyeti përse Kosova ka dy ministra të Jashtëm në tryezë. "Përse Kosova ka dy ministra të Jashtëm në tryezë? Ky është një provokim i rëndë që na bëhet nga ministri i Jashtëm, Edi Rama", tha z.Daçiç.

dhe linjëzimit të plotë me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së. "Kemi marrë një notë shkajshmerisht pozitive për veprimtarinë e deritashme të institucioneve të Shqipërisë në procesin e përafrimit të legjislacionit dhe në fund, po ashtu kemi diskutuar për domosdoshmërinë e thellimit të komunikimit politik për të arritur objektivin e synuar për hapjen e negociatave për anëtarësim në vitin 2019", deklaroi ministri Cakaj.

SHKURT

Gjykata vendos për ish-deputetin e PDIU: S'ka kthim në Kuvend

Gjykata Administrative rrezoi padinë e deputetit të PDIU, Aqif Rakipi ndaj KQZ-së pas vendimit për ta shkarkuar si subjekt i dekriminalizimit. Rakipi e cilësoi të padrejtë shkarkimin dhe kërkoi rikthimin e mandatit. Por, gjykata e cilësoi të drejtë vendimin e KQZ-së, duke argumentuar se deputeti Rakipi fshehu problemet me drejtësinë që kishte në Itali. Në vendim thuhet se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendos rrezimin e padisë dhe se kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Vendimi është dhënë më 17 dhjetor të vitit 2018. "Gjykata arrin në konkluzionin se padia e parajtur prej paditësit duhet rrezuar si e pabazuar në ligj dhe prova", thuhet në vendim. Në qershor 2018, KQZ-ja miratoi me 5 vota pro heqjen e mandatit të Rakipit, sipas kërkesës së prokurorisë, në kuadër të ligjit për dekriminalizimin.

Në raportin e prokurorisë shkruhet se deputeti Aqif Rakipi është ndaluar në Itali për vjedhje në 3.11.1998 nën emrin Skënder Ejlbegaj dhe këtë ai s'e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit.

LSI, Vasili: KLP-ja po thellohet në rrugën e paligjshmërisë

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, adresoi dje akuzat të forta për mënyrën e konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ai shprehet se ky organ ka hyrë në rrugën e paligjshmërisë, duke mos dhënë asnjë shpjegim për mënyrën se si merr vendimet dhe mbi çfarë nenesh apo rregullash kushtetuese bazohet. "E mbledhur pa ligj, pasi nenet janë shfuqizuar, duke bërë edhe zgjedhje e marrë vendime brenda vetes KLP po ecën kundër ligjit dhe jo në krah të tij. Edhe pse të zgjedhur anëtarët e KLD, dispozita, që rregullon mënyrën e thirrjes dhe mbledhjes së këtij organi kolegial nuk ekziston, pasi ato rezultojnë të shfuqizuara (neni 61 dhe neni 159 i ligjit nr.115/2016 "Për organet qeverisëse në sistemin e drejtësisë", janë shfuqizuar tërësisht). Pra, ka vakum dhe mungesë rregullash se si ky organ mblihdet dhe nuk ekziston asnjë rregull se çfarë të drejta ka KLP, çfarë aktesh nënligjore mund të vendosë", shprehet z.Vasili.

Sekuestrohen 4 laboratorë që përdoreshin nga trafikantët për prodhimin e dokumenteve false

Trafikonin klandestinë drejt BE-së dhe SHBA-ve, përfundojnë në pranga 32 persona e 4 në kërkim

Megaoperacioni në Tiranë, Lezhë, Shkodër, Delvinë, Sarandë e Durrës, mes të arrestuarve edhe 1 efektiv policie

TIRANË

Trafiku u klandestineve nga Shqipëria me destinacion vendet e BE-së dhe SHBA-të ka çuar në pranga 32 persona, mes të cilëve edhe një efektiv policie. Megaoperacioni i koduar "Rruga e gabuar" u finalizua nga Policia e Shtetit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ky operacion u zhvillua në disa qytete të vendit si Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Fier, Berat, Lushnjë, Krujë, Elbasan, Tiranë, Korçë etj. Mësohet se grupi përbëhej nga 36 persona, ndërsa 4 prej tyre vijojnë të jenë ende në arrati, së bashku me kokën e grupit, i identifikuar me iniciale G.B. Ndërkaq, po të njëjtat burime pohuan se janë sekuestruar edhe katër laboratorë, që përdoreshin nga trafikantët për prodhimin e dokumenteve false.

MEGAOPERACIONI

"Operacioni policor 'Rruga e gabuar', goditet grupi kriminal me 36 anëtarë të dyshuar. Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë dhe organet e tjera ligjzbatuese në vend, si dhe me ndihmën e agjentëve të Sigurisë së Shërbimit Diplomatik të atashuar në ambasadën amerikane (DSS), finalizuan me sukses operacionin. Gjatë këtij operacioni janë arrestuar 32 shtetas shqiptarë, mes tyre 1 punonjës policie, si dhe janë shpallur në kërkim 4 shtetas të tjerë. Nga të arrestuarit, 6 prej tyre janë me masë sigurie 'Arrest shtëpie'. Ndërkohë, u zhbluan e sekuestruan 4 laboratorë në Shqipëri që shërbenin për falsifikimin e dokumenteve, pajisje të ndryshme si skaner, fotokopje, një sasi e madhe parash 'cash', certifikata, karta identiteti, një numër i konsiderueshëm dokumentesh të personave si dhe një armë zjarri automatik", thuhet ndër të tjerat në njoftimin zyrtar të policisë. Po të njëjtat burime sqaruan se në koordinim të plotë me prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda u kryen ndalimet për veprat penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihi me kalim të paligjshëm të kufijve" si dhe "Grupi i strukturuar kriminal, të kryer në bashkëpunim". Personat e arrestuar janë: A.Sh., 46 vjeç, nga Tirana; S.K., 60 vjeç, nga Tirana; R.H., 43 vjeç, nga Gjirokastrë;

D.S., 35 vjeç nga Gjirokastrë; L.M., 61 vjeç, nga Përmeti; A.Z., 48 vjeç, nga Delvina; E.O., 52 vjeç nga Saranda; K.Gj., 32 vjeç, nga Korça; A.D., 54 vjeç, nga Korça; P.B., 59 vjeç, nga Vlorë; G.Sh., 32 vjeç, nga Tirana; B.M., 52 vjeç, nga Kruja; A.K., 35 vjeçe, nga Mallakastra; Gj.M., 46 vjeç nga Vlorë; A.E., 47 vjeç nga Saranda; E.M., 31 vjeç nga Fieri; I.M., 59 vjeç nga Gjirokastra; S.Ç., 55 vjeç, nga Gjirokastra; M.M., 31 vjeç, nga Lushnja (në banesë iu gjet armë zjarri kallashnikovë); D.T., 50 vjeç, nga Elbasani; B.H., 45 vjeç, nga Berati; Ç.T., 48 vjeç, nga Gjirokastra; V.Gj., 50 vjeç, nga Gjirokastra; M.Sh., 46 vjeç, nga Gjirokastra; V.G., 54 vjeç, nga Saranda; E.B., 28 vjeç, nga Tepelena (me detyrë punonjës policie); Sh.Sh., 65 vjeç nga Saranda (arrest shtëpie); E.M., 56 vjeç, nga Fieri (arrest shtëpie) J.G., 69 vjeç, nga Delvina (arrest shtëpie); A.L., 52 vjeç, nga Kruja (arrest shtëpie); I.M., 35 vjeç, nga Tirana (arrest shtëpie) Z.Xh., 57 vjeçe, nga Vlorë (arrest shtëpie). Operacioni u zhvillua në bashkëpunim dhe me Drejtoritë Vendore të Policisë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë, ku u përfshinë rreth 250 forca policie.

Operacioni u zhvillua në disa qytete të vendit, në Sarandë, Delvinë,

Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Fier, Berat, Lushnjë, Krujë, Elbasan, Tiranë, Korçë, etj.. Ky operacion u zhvillua në vijim të procedimit penal "272", në bazë të hetimeve dhe informacioneve të siguruar nga Policia e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese vendëse e të huaja, ku u godit pjesa tjetër e grupit të strukturuar kriminal, që vazhdonte aktivitetin pas goditjes në vitin 2018.

HETIMET

Nga veprimet hetimore të kryera në funksion të këtij procedimi penal rezultoi se shtetasit e mësipërm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal siguronin persona, të cilët kishin interes për të udhëtuar në shtetet e BE-së, si dhe atyre shtetasve që u ishte ndaluar hyrja në një nga vendet e hapësirës Schengen. Anëtarët e këtij grupi kriminal, pasi i pajisnin shtetasit me dokumente identifikimi të falsifikuara kundrejt përfitimimit monetar, u krijonin kushtet në mënyrë të paligjshme që të udhëtonin drejt vendeve të BE-së, me linja ajrore ose tokësore e më pas drejt SHBA-ve, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke paguar shuma të konsiderueshme nga 10 mijë paund për në Mbretërinë e

Bashkuar, deri në 20 mijë euro për në SHBA e Kanada. Ky grup kriminal ka pajisur me dokumente të falsifikuara edhe shtetas me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Nisja e personave me dokumente të falsifikuara bëhej nga Shqipëria, Mali i Zi, Italia, Greqia, Franca dhe Norvegjia. Në funksion të këtij hetimi janë dokumentuar disa episode, ku personat e mësipërm kanë falsifikuar dokumente të udhëtimit dhe u kanë dhënë ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit disa shtetasve. Në këtë veprimtari kriminale është evidentuar përfshirja edhe e një punonjësi të policisë, i cili duke shpërdoruar detyrën ka kryer veprime korruptive kundrejt shumave monetare, si dhe ka ndihmuar pjesëtarët e këtij grupi kriminal duke shfrytëzuar të dhënat që dispononte për shkak të detyrës në një pikë kontrolli kufitar. Gjatë operacionit nga policia janë gjetur dhe sekuestruar shumë prova materiale, që shërbenin për ushtrimin e këtij aktiviteti kriminal. Policia e Shtetit në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë po vijon punën për dokumentimin e plotë dhe zbardhjen e të gjithë skemës së falsifikimit të dokumenteve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe personat e tjerë të përfshirë.



Ardi Veliu gjatë konferencës së djeshme për shtyp

20.000

EURO

Operacioni u zhvillua në disa qytete të vendit si: Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Fier, Berat, Lushnjë, Krujë, Elbasan, Tiranë, Korçë etj., ku u përfshinë rreth 250 forca policie. Sipas policisë, anëtarët e grupit kriminal, pasi i pajisnin shtetasit me dokumente identifikimi të falsifikuara kundrejt përfitimimit monetar, u krijonin kushtet në mënyrë të paligjshme të udhëtonin drejt vendeve të BE-së, me linja ajrore ose tokësore e më pas drejt SHBA-ve, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke paguar shuma të konsiderueshme nga 10 mijë paund për në Mbretërinë e Bashkuar, deri në 20 mijë euro për në SHBA e Kanada.

PERSONAT E ARRESTUAR

1.A.Sh.,	46 vjeç,	nga Tirana
2.S.K.,	60 vjeç,	nga Tirana
3.R.H.,	43 vjeç,	nga Gjirokastra
4.D.S.,	35 vjeç,	nga Gjirokastra
5.L.M.,	61 vjeç,	nga Përmeti
6.A.Z.,	48 vjeç,	nga Delvina
7.E.O.,	52 vjeçe,	nga Saranda
8.K.Gj,	52 vjeç,	nga Korça
9.A.D.,	54 vjeç,	nga Korça
10.P.B.,	59 vjeç,	nga Vlorë
11.G.Sh.,	32 vjeç,	nga Tirana
12.B.M.,	52 vjeç,	nga Kruja
13.A.K.,	35 vjeçe,	nga Mallakastra
14.Gj.M.,	46 vjeç,	nga Vlorë
15.A.E.,	47 vjeç,	nga Saranda
16.E.M.,	31 vjeç,	nga Fieri
17.I.M.,	59 vjeç,	nga Gjirokastra
18.S.Ç.,	55 vjeç,	nga Gjirokastra
19.M.M.,	31 vjeç,	nga Lushnja
20.D.T.,	50 vjeç,	nga Elbasani
21.B.H.,	45 vjeç,	nga Berati
22.Ç.T.,	48 vjeç,	nga Gjirokastra
23.V.Gj.,	50 vjeç,	nga Gjirokastra
24.M.Sh.,	46 vjeç,	nga Gjirokastra
25.V.G.,	54 vjeç,	nga Saranda
26.E.B.,	28 vjeç,	nga Tepelena (me detyrë punonjës policie)
27.Sh.Sh.,	65 vjeç,	nga Saranda (arrest shtëpie)
28.E.M.,	56 vjeç,	nga Fieri (arrest shtëpie)
29.J.G.,	69 vjeç,	nga Delvina (arrest shtëpie)
30.A.L.,	52 vjeç,	nga Kruja (arrest shtëpie)
31.I.M.,	35 vjeç,	nga Tirana (arrest shtëpie)
32.Z.Xh.,	57 vjeçe,	nga Vlorë (arrest shtëpie)

Janë rreth 30 mijë apartamente që do të marrin lejen dhe hipotekën

Lame: Legalizimi i pallateve, procedurat që duhet të ndjekin banorët

Rastet me shkelje që do të përfitojnë legalizim

Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, shpërndau lejet e legalizimit për banorët e tri kullave në Tiranë, në zonën e Kasharit, afër "Astirit". Drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame bëri të ditur se subjekti ndërtues ka qenë i gatshëm për të vazhduar vetë procedurën e legalizimit dhe më pas hipotekimit të njësive të banimit dhe shërbimit. Me këtë rast, drejtori i Artan Lame u bëri thirrje të gjithë qytetarëve për të bashkëpunuar me ALUIZNI-n, nëse investitori nuk përgjigjet për të vazhduar procedurën e hipotekimit të banesave të tyre. "Bashkëpunimi mes qytetarëve dhe institucionit do e bëjë më të thjeshtë dhe më të shpejtë procesin e legalizimit dhe më pas hipotekimit e apartamenteve, në rastet kur investitori i ka braktisur apo nuk jeton më", - tha Lame.

APARTAMENTET

Janë rreth 30 mijë apartamente që do të marrin tapitë pa asnjë kosto. Janë disa kategori pallatesh që presin të legalizohen. Pjesa më e madhe e përfituesve, rreth 1230 pallate, janë në Tiranë. Objektet janë ndërtuar pa leje, kanë shkelur lejet duke ndërtuar shtesa, ose ndërtuesi ka vdekur, ose është zhdukur pa përmbytur detyrimet për pajisjen me hipotekë të apartamenteve.

APLIKIMI

ALUIZNI u kërkon banorëve që jetojnë në pallate të pahipotekuara të njoftojnë pushtetin vendor, të bashkëpunojnë me Agjencinë e Legalizimeve dhe me njëritjetrin për të përmbyllur procesin e legalizimit. Thuajse në të gjitha daljet e tij për mediat pa nisjes së procedurave për legalizimin e pallateve me shkelje lejeje u bën thirrje banorëve të bashkëpunojnë me agjencinë. "Organizohuni dhe na ndihmoni, na sillni informacion për ta vazhduar procesin edhe për objekte të tjera. Bashkëpunimi me qeverisjen vendore është i domosdoshëm dhe ne e bëjmë, sepse kjo është pjesë e punës sonë", - u tha Lame banorëve. Sipas kreut të ALUIZNI-t, janë një numër i madh objektiv, pallate masive në të cilat pronarët e kanë humbur farenë të interesit. "Është e vështirë të komunikosh banor për banor në një pallat dhe kjo kërkon që banorët të mundohen të gjejnë një përfaqësi, inxhinier, jurist për të ndjekur procedurat. Ka një mori objektiv ku po përfitojnë procedurat me banorët, sepse kemi arritur të organizohemi. Siç ka edhe një numër objektivsh për të cilat ka përfunduar legalizimi dhe pallatet kanë marrë edhe lejet e legalizimit", - tha Lame.



ARTAN LAME

Kreu i ALUIZNI-t, Lame, u bëri thirrje të gjithë qytetarëve të bashkëpunojnë me ALUIZNI-n, nëse investitori nuk përgjigjet për të vazhduar procedurën e hipotekimit të banesave të tyre. "Fakti që janë disa qindra familje që banojnë në to, procedurat kanë filluar prej vitesh. Janë pallate të ndërtuara që në vitet 2011-2012. Ju keni hyrë në 2013-ën dhe gjithë kjo periudhë është dashur për të pritur. Është arritur në rreth 140 pallate të tjera, të cilat janë legalizuar gjatë 2018-ës. Të mblidhen banorët dhe të bëhen bashkë dhe të vazhdojnë procedurat për legalizim, duhet të vazhdojnë dhe të tjerët", - tha Lame.

RASTET QË DO TË PËRFITOJNË LEGALIZIM

RASTET ME SHKELJE QË DO TË PËRFITOJNË LEGALIZIM

1. Procedurat e legalizimit të objektivit me leje ndërtimi, në të cilin janë kryer shtesa, anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshim i funksionit të hapësirave, kryhen në favor të poseduesve (si porositës apo pronarë trullall, sipas kontratave të porosisë/sipërmarrjes ose akt marrëveshjes) në rastet e mëposhtme:

a) Subjekti ndërtues/investitori është në kushtet e nenit 99 (ose 187) të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për shqëritë tregtare", të ndryshuar; ose:

b) Subjekti ndërtues/investitori nuk dorëzon brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e njoftimit dokumentacionin e kërkuar zyrtarisht nga ALUIZNI sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar; ose nuk shlyen, brenda të njëjtit afat, detyrimet financiarë sipas nenit 43, të të njëjtit ligj. Këtu përshihet dhe rasti kur subjekti rezultoi me veprimtari të pezulluar prej të paktën 1 viti, sipas informacionit të administratorit nga Qendra Kombëtare e Biznesit; ose:

c) Subjekti ndërtues/investitori nuk ka paraqitur aplikim për legalizim, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij

vendimi.

2. Kur plotësohen kushtet e pikës 1, të këtij vendimi, drejtoritë e ALUIZNI-t vijojnë legalizimin në favor të poseduesve të apartamenteve ose ambienteve me funksion social-ekonomik në vijim të quajtura "njësi individuale", sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim.

3. Drejtoritë e varësë të ALUIZNI-t, pas kryerjes së procedurave të evidentimit në terren, hartojnë listat e ndërtimeve të ngritura nga subjektet që gjenden në kushtet e pikës 1, të këtij vendimi, si dhe listën e poseduesve të njësive individuale dhe i afishojnë ato në faqen zyrtare të ALUIZNI-t, në ambientet e drejtorive dhe të objekteve që do t'i nënshtrohen procesit të legalizimit, si dhe pranë njësive të qeverisjes vendore.

4. Legalizimi dhe regjistrimi për objektet që trajtohen sipas këtij kreu, në varësi të gjendjes ligjore, kryhen në dy fazat:

a) Miratimi i lejes së legalizimit për objektin kryesor (sipas projektit të miratuar nga organi kompetent) së bashku me shtesat anësore dhe/ose në lartësi të realizuara dhe të deklaruara nga subjekti ndërtues dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP në emër të ALUIZNI-t.

b) Miratimi i lejes së legalizimit për shtesat anësore dhe/ose në lartësi të realizuara dhe të deklaruara nga vetë subjekti posedues.

5. U nënshtrohen kritereve kualifikuese të parashikuara në vendimin nr.280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa

leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", vetëm shtesat në të njëjtin të lejes së ndërtimit. Nëse shtesa gjendet në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, legalizohet dhe regjistrohet vetëm objekti kryesor.

6. Poseduesit e njësive individuale duhet të dorëzojnë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e afishimit publik sipas pikës 3, të këtij vendimi, dokumentacionin që provon marrëdhënien juridiko-civile me subjektin ndërtues/investitor Miratimi i lejeve të legalizimit për njësi individuale në favor të poseduesve kryhet pas zbatimit të procedurës së përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij vendimi.

7. Nëse objekti me leje ndërtimi, në të cilin janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshim i funksionit të hapësirave është ngritur në truall privat, pronarët e truallit përfitojnë pjesët përkatëse në objektin kryesor dhe në shtesat e realizuara nga subjekti ndërtues/investitor, në përputhje me shkronjën "c", të nenit 37, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

8. Njësi të individuale, për të cilat nuk janë lidhur kontrata porosisë/sipërmarrjeje ose akt marrëveshjeje, legalizohen në emër të subjektit ndërtues/investitor, me përjashtim të atyre që i takojnë pronarit të truallit sipas paragrafit të dytë, të shkronjës "c", të nenit 37, të ligjit të sipërmendur. Në rastet e shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, kur mbi njësinë individuale nuk ka pretendime nga të tretët, ajo legalizohet në

favor të shtetit.

9. Në rastet e ekzekutimit të detyrueshëm mbi objektin apo mbi njësi të individuale zbatohen përcaktimet e pikave 8/3 deri në 8/7, të vendimit nr.280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", të ndryshuar.

LEGALIZIMI NË EMËR TË SUBJEKTI TË NDËRTUES/INVESTITOR

1. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, që nuk trajtohen sipas kreu I, të këtij vendimi, leja e legalizimit miratohet për subjektin ndërtues/investitor që rezultoi i tillë nga leja e ndërtimit apo për subjektin që ka fituar të drejta mbi ndërtimin, nëpërmjet:

a) Veprimeve juridiko-civile (kontrata, akte noterale) për kalimin e të drejtave mbi objektin, nga investitori/ndërtuesi të një subjekti tjetër.

b) Vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Legalizimi nuk pengohet nga detyrimet tatimore që kanë palët si rezultat i veprimeve të kryera më parë për kalimin e të drejtave mbi objektin dhe as nuk i shuan këto detyrime. Sipas kësaj pike, ALUIZNI, në momentin e dërgimit të lejes së legalizimit për regjistrim përcjell kopje të dokumentacionit të praktikës për vlerësimin e detyrimeve tatimore, pranë drejtorisë rajonale të tatimeve.

Kur kalimi i të drejtave mbi objektin është kryer pa kundërshtim, zbatohen

përcaktimet e pikës 9, të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr.9, datë 26.2.2008, të ndryshuar.

3. Rregullat e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 9, të këtij vendimi zbatohen edhe për objektet që legalizohen sipas këtij kreu.

LEGALIZIMI I OBJEKTIVIT ME LEJE NDËRTIMI, TË DESTINUARA PËR KALIM PRONËSIE APO QIRADHËNIE

1. Evidentimi i objekteve shumëkatëshe (mbi 5 kate), të ngritura pa leje ndërtimi të organeve kompetente, për qëllim shitblerjeje apo qiradhenieje të njësive individuale të banimit apo shërbimit kryhet nga drejtoritë e ALUIZNI-t, nëpërmjet bashkërdimit dhe shkëmbimit të informacionit me njësi të qeverisjes vendore si dhe nëpërmjet procedurave të evidentimit në terren.

2. Subjekti, që ka ngrietur ndërtime pa leje me qëllim shitblerjeje dhe/ose qiradhenieje, paguan:

a) Taksonë e ndikimit në infrastrukturë sipas ligjit për sistemin e taksave vendore. Procedura që ndiqet në zbatim të kësaj pike është ajo e përcaktuar në pikën 5, të vendimit nr.860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtime pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", të ndryshuar.

Ahmetaj: 'S&P' vlerëson Shqipërinë, notë pozitive për ekonominë e vendit

"Standard and Poor's": PPP, rrezik i madh

"S&P": Ministrat e rinj mund të ngadalësojnë

Gjiganti i vlerësimit të kreditit, "Standard and Poor's", ka mbajtur të pandryshuar në B+ me perspektivë të qëndrueshme notën e borxhit sovran të Shqipërisë. Sa u përket rrezeve fiskale, ajo që bie në sy që në fillim të njoftimit për shtyp është paralajmërimi në lidhje me PPP. Skemat e Partneritetit Publik Privat vazhdojnë të përbëjnë një rrezik thelbësor fiskal - thotë "Standard and Poor's" për Shqipërinë. Ndër të tjera, agjencia projekton vullnet të autoriteteve shqiptare për konsolidimin fiskal, si dhe një rënie graduale të normës së borxhit publik në raport me PBB. Rritja ekonomike projektohet pranë 4% mesatarisht deri në 2022. Ndërsa në lidhje me parashikimin për rritjen ekonomike të këtij viti, "Standard and Poor's" e parashikon në nivelin 3.9%. Ndërkohë, projekcioni i qeverisë për rritjen ekonomike është 4.3%. Në dy vitet e ardhshme, agjencia paralajmëron një rritje të notës së borxhit sovran, në rast se do të vihet re një përkushtim më i madh në konsolidimin fiskal dhe sidomos një trajektore rënës me domethënëse e borxhit publik. Nga ana tjetër, gjatë dy viteve të ardhshme, nota e borxhit mund edhe të ulet në rast se do të konkretizohen disa rreze, si ai i PPP. Materializimi i detyrimeve të prapam-



betura si rrjedhojë e këtyre projekteve mund të çojë në zhvlerësim të Shqipërisë - paralajmëron 'S&P'. Agjencia flet edhe për ndryshimet më të fundit në qeveri. "Pavarësisht zhvendësimit të disa ministrave të kabinetit, ne presim që qeveria të vazhdojë përpara

me reformat strukturore, por janë të mundura vonesa në implementimin e tyre. Ne nuk presim që zhvendësimi i 7 ministrave, ose gjysmës së kabinetit do të përkthehet në një ndryshim të politikave aktuale të qeverisë", - thotë më tej agjencia. "Pritshmëritë tona

janë që Partia Socialiste, fituese e vetme e zgjedhjeve të 2017-ës të implementojë reformat në ekonomi, administratën publike dhe veçanërisht në gjyqësor. Vullti i reformave mund të ngadalësohet në muajt në vijim me ministrat e rinj", thotë më tej 'S&P'. **REAGIMI**

Kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Arben Ahmetaj, ka reaguar duke e vlerësuar raportin "Standard and Poor" si një notë tjetër pozitive përveç FMN-së, për ekonominë shqiptare. Në raport rritja ekonomike konfirmohet në 4.2% për vitin 2018, gjithashtu vlerësohet vazhdimi i konsolidimit fiskal, ulja e mëtejshme e borxhit publik dhe deficitit dhe përmirësimi i klimës së biznesit e investimeve të huaja, që do të mbeten solide edhe përgjatë viteve në vijim. 'S&P' vlerëson me nota tejet pozitive perfor-

mançën fiskale të ekonomisë dhe thekson se Shqipëria në aspektin fiskal performon më mirë se vendet fqinje në rajon me renditjen B+, si rezultat i rritjes ekonomike të shëndetshme dhe angazhimit të qeverisë për uljen e vazhdueshme të borxhit publik, në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit. Borxhi publik do të vijojë trajektoren ulëse drejt nivelit 60% në 2022. Po ashtu, 'S&P' vlerëson se rritja ekonomike në periudhën në vijim do të mbështetet te rritja e konsumit dhe punësimit. Perspektiva pozitive në afatmesëm dhe afatgjatë ka reflektuar zgjerimin e ekonomisë shqiptare me mesatarisht 4% përgjatë viteve në vijim, e mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe eksportet, kryesisht ato të shërbimeve, uljen e mëtejshme të deficitit fiskal, uljen graduale të deficitit të llogarisë korrente, i cili do të mbulohet kryesisht nga

Tabaku: Rriten taksat e tarifave, Shqipëria në zgripin e errësirës

Përmes një postimi në "Facebook", deputetja e PD, Jorida Tabaku ka thënë se vendi ndodhet në zgripin e errësirës, pasi është shteti më pak i ndërlidhur sa u përket investimeve në rajon dhe më gjerë. Sipas Tabakut, Shqipëria nga janari 2014 është gdhirë një vend i mbushur në taksat dhe tarifa të reja, ndërsa alternativa është programi ekonomik i PD-së për të nxjerrë vendin nga kjo situatë. "Shqiptarët janë sot një popullsi që nuk ka dëshirë të sipërmarrë biznese, inovacione, por vetëm sipërmarrjen për emigrim. Rreth 400 mijë veta kanë tentuar apo janë larguar nga Shqipëria", - thotë Tabaku.

flukset e investimeve të huaja direkte si edhe rritjen e qëndrueshme të të ardhurave, mbështetur nga performanca e fortë ekonomike dhe mirë administrimi. Një kusht i rëndësishëm është edhe vazhdimi i reformave për përmirësimin e klimës së biznesit, ndërsa Shqipëria mund të përfitojë nga projekte investimesh të huaja direkte me bazë të gjerë, në sektorë me vlerë të shtuar, sikurse ka filluar tashmë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, apo shërbimet e biznesit.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Ish-oficeri i forcave speciale greke: Nuk jam unë, të mos merret si provë

Vrasja e Devi Kasmit, prokuroria: Ja prova që "gozhdon" Efthimios Efthimiu

Publikohet video, ekzekutori u largua nga vendngjarja me furgon të bardhë

SHKURT

U kapën në Sauk me 5.2 kg heroinë, lihen në burg 3 nga 4 të arrestuarit

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka vendosur të lërë në burg tre nga katër personat e arrestuar nën operacionin "Vollga" në Tiranë, ku u sekuestruan 5.2 kg heroinë që vinte nga Maqedonia në Shqipëri me destinacionin qytetin bregdetar. Operacioni u finalizua në hyrje të Tiranës prej nga vjen nga Elbasani, pranë rreth-rrotullimit të Saukut, ku policia ndërhyri pas dyshimit për një dekonspirim. Kështu, Gjykata Durrës pranoi dhe la në fuqi kërkesën e Prokurorisë Durrës për çështjen e prokurorit Madrid Kulloli për vlerësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg për shtetasit: Besmir Dashi, lindur në Librazhd dhe banues në fshatin Rrajcë Librazhd, i padënuar, për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Amir Troci, lindur në Dibër dhe banues në Kodër Kamëz Tiranë, i padënuar, për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Nexhmi Uka, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i dënuar për veprën penale të "Prodhim dhe shitje e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Ndërkohë, për Alban Raitën, lindur në Dibër dhe banues në Kodër Kamëz Tiranë, i padënuar, për veprën penale të "Prodhimit dhe shitja e narkotikëve", gjykata ka vendosur të vlerësojë të ligjshëm ndalimin dhe caktimin e masës së sigurimit "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore" një herë në muaj. Në kuadër të operacionit të koduar "Vollga" janë sekuestruar 5 kg të dyshuar heroinë, një sasi monetare, 3 automjetet e disa telefona.

Klodiana Lala

Tiranë

Një vit pas vrasjes së Devi Kasmit, publiko het video pak momente pas ekzekutimit të tij. Personi që shfaqet në këto pamje dyshohet të jetë ish-oficeri i forcave speciale greke, Efthimios Efthimiu. Ai u fokusua nga kamerat e sigurisë së bizneseve në rrugën "Kongresi i Manastirit", në orën 19.26 të mbrëmjes së 29 janarit 2018, pak minuta pasi ekzekutoi Devi Kasmi, krim të cilin dyshohet se e kreu me pagësë. "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" siguroi pamjet filmike, të cilat do të përdoren në gjykatë si provë kundër Efthimiut dhe personave të tjerë të dyshuar për vrasjen. Siç dallohet qartë, në rrugën "Kongresi i Manastirit" mbërrin një furgon i bardhë, i mbyllur në pjesën e pasme. Mjeti qëndron në pritje pak sekonda. Bën disa lëvizje para mbrapa. Aty vjen me hap normal, një person që mban veshur një xhup të bardhë dhe kapuç në kokë. Fytyrën e ka të zbuluar. Ngjitet në vendin e parë dhe furgoni largohet. Referuar dosjes hetimore, rezultoi se shtetasi grek ka hyrë në



Ish-oficeri i forcave speciale greke, Efthimios Efthimiu



Viktima, Devi Kasmi



Efthimios Efthimiu duke u larguar nga scena e krimit

rrugën "Petro Cani" pranë Peditrisë, rreth orës 18.30. Sipas prokurorisë, ai e priti disa kohë viktimën e tij dhe menjëherë sapo Kasmi mbërriti poshtë pallatit të tij, e qëlloi me katër plumba. Pas krimit, ish-speciali grek zgjedh të largohet nga një

tjetër rrugicë, duke dalë sërisht në rrugën "Kongresi i Manastirit", siç dallohet në pamjet filmike. Në dosje thuhet se furgoni që drejtohet nga i pandehuri Malvin Dinellari vijon rrugën, duke dalë në zonën e "Bërryllit" dhe merr drejtimin për nga Pal-

VRASJA

Devi Kasmi u ekzekutoi me 4 plumba mbrëmjen e 29 janarit të vitit 2018 në rrugën "Kongresi i Manastirit", në afërsi të Urgjencës së Peditrisë në Tiranë. Atentatorët që thuhet se kanë qenë hipur në një motor dhe të pajisur me skafandra priten deri sa objektivi i tyre doli nga banesa, ndërsa qëlluan ndaj tij duke e lënë të vdekur në vend. Fill pas krimit, ata u larguan me shpejtësi në drejtim të SHISH, duke fshehur kështu gjurmët, pasi përfituan edhe nga errësira në vendin ku ndodhi vrasja.

lati me Shigjeta. Një kamera sigurie e vendosur tek kryqëzimi i Drejtorisë së Policisë së Tiranës ka fiksuar targën e automjetit, AA 231 JH. Prokuroria mundi të zbulojë se furgoni ishte blerë 12 ditë përpara ngjarjes nga pjesëtarët e grupit kriminal të drejtuar nga Aurel Hoxhallari, që është në arrati. Disa ditë pas krimit, po i njëjti furgon u gjet në shtëpinë e Hoxhallarit në zonën e Kasharit, aty ku dhe u zbulua një arsenal i madh armësh. Greku Efthimios monoh kategorikisht të jetë ai personi në video dhe përmes

avokatit të tij, Saimir Visha, do t'i kërkojë gjykatës rrëzimin e kësaj prove. Tashmë një vit pas krimit që tronditi Tiranën, Prokuroria për Krime të Rënda përfundoi hetimet dhe dorëzoi dosjen në gjykatë. Listën e të pandehurve e kryeson shtetasi grek, pasi akuzohet si ekzekutor, ndërsa grupin kriminal që porositi dhe pagoi vrasjen dyshohet se e drejtonte Aurel Hoxhallari. Ndaj të pandehurve rëndojnë akuzat e vrasjes me paramendim kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe armëmbajtje pa leje.

Ekzekutoi avokatin grek, kamerat zbulojnë grabitësin shqiptar, Eno Mata

GREQI - Shqiptari 32-vjeçar, Eno Mata, i kërkuar nga policia për vrasjen e avokatit Mihalis Zafirooulos është një nga autorët e vjedhjes së kryer në Ambelokipi, Athinë, të enjten herët në mëngjes.

Eno Mata dhe një person i paidentifikuar akoma kanë vjedhur dyqanin me bizhuteri rreth orës 06:00, pasi kanë qëlluar lehtë vajzën e pronarit. Në kamerën e sigurisë duket



qartë shqiptari pa maskë dhe një person tjetër i maskuar. Pas vrasjes së Mihalis Zafirooulos, që Eno Mata kreu bashkë me Ibrahim Brahimaj (vrasësin e

Arbër Bako në burgun e Koridhalosë), 32-vjeçari shqiptar ka kryer 3 vjedhje, 2 në dyqane me bizhuteri në Athinë dhe një bankë në Mesini. Në qershor të vitit 2018, Mata la një letër për policinë me pseudonimin "Maradona Fluturues", ku shfaqësor për çështjen Zafirooulos, duke thënë se janë viktima konspiracioni dhe se është hajdut, jo vrasës.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pajisje kanlecarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,500,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pajisje kanlecarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **25 Shkurt 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Biznesmenit iu sekuestrua në dhjetor të 2018-ës edhe një pallat 2 mln euro

SHKODËR

Dy muaj pas sekuesimit të një pallati 10-katësh me vlerë 2 milionë euro, biznesmenit Bardhok Pllanaj i janë sekuestruar dhjetëra prona të tjera të luajtshme e të paluajtshme. Burime zyrtare nga prokuroria dhe bënë me dije se 44-vjeçarit iu vendosën nën sekuestro një sipërfaqe e konsiderueshme toke (rreth 13 mijë m²), 6 apartamente, 5 bodrume dhe disa makina. Prona dyshohet se është përfituar përmes falsifikimit të dokumenteve dhe korrupsionit. Bardhok Pllanaj, një prej emrave më të njohur në Shkodër, u prangos më 4 dhjetor 2018 për pastrim parash, ndërtim i paligjshëm dhe falsifikim. Ndërkohë që Gjykata e Shkodrës ka dhënë masën e sigurisë "Arrest shtëpie" ndaj tij për shkak të disa komplikacioneve shëndetësore. Ai ka qëndruar rreth 3 javë në reanimacionin e spitalit të qytetit verior. Emri i biznesmenit do të lakohej për herë të parë në vitin 2014, gjatë operacionit policor "Laguna e Vilunit", ku u sekuestruan gati një ton hashash. Shtatë persona u arrestuan, por Pllanaj arriti t'i shmangej kapjes. Sipas Partisë Demokratike në atë kohë, për t'iu shpëtuar prangave, trafikanti u fshih në automjetin e ish-deputetit Mark Frrroku, por ky i fundit mohoi akuzat. 44-vjeçari rezultoi pronar i 20 pronave, apartamente, biznese, trojeve, makinave etj. Gjykata e Shkodrës miratoi kërkesën e prokurorisë për sekuestro pasurisë pas referimit nga policia.

PRONAT E SEKUESTRUARA

Prokuroria Shkodër ka regjistruar aktet e dy procedimeve penale të vitit 2018 për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Ndërtimit të paligjshëm" dhe "Pastrimit të produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 248, 199/a/3 dhe 287 të Kodit Penal, pas dërgimit të materialeve referuese nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër. Bazuar nga hetimet, Prokuroria e Shkodrës kërkoi përpara gjykatës sekuestro preventive të pasurive të paluajtshme e të luajtshme, me qëllim që disponimi i tyre të mos zgjatë pasojat e veprave penale të cituara më sipër apo t'i rëndojë ato, si edhe të shmangë qdo transaksion, tjetërsim apo veprim tjetër administrativ mbi të, çka do të shkaktojë kryerjen e veprave penale të tjera.

Andaj, në bazë të nenit 274 të K. Pr. Penale u vendos caktimi i masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive për pasuritë e mëposhtme:

I. PASURITË TË PALUAJTSHME:

1) Pasuria ndodhur në Dobraq, njësi 20 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3704.

2) Pasuria ndodhur në Dobraq, bodrum 46,8 m² në

Prokuroria sekuestron 20 pasuri të "sheikut" të Shkodrës, Bardhok Pllanaj

Dyshohet se janë ngritur nga aktiviteti kriminal, nën sekuestro mijëra m² tokë, 6 apartamente, bodrume e makina



Biznesmeni Bardhok Pllanaj

pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3930.

3) Pasuria ndodhur në Dobraq, bodrum 24,3 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3930.

4) Pasuria ndodhur në Dobraq, bodrum 24,3 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3930.

5) Pasuria ndodhur në Dobraq, bodrum 943,7 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

6) Pasuria ndodhur në Dobraq, bodrum 1255,5 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200, fituar sipas lejes së legalizimit nr.

92580, datë 21.01.2015.

7) Pasuria ndodhur në Dobraq, njësi 548,65 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

8) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 103 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

9) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 80 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

10) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 83 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

11) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 80 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i

ARRESTIMI I PLLANAJT

Pas një hetimi disamujor, më 3 dhjetor të vitit që shkoi policia e Shkodrës arrestoi biznesmenin Bardhok Pllanaj, banues në fshatin Shtoj i Vjetër, pasi akuzohet për pastrim parash, falsifikim të vulave, stampave ose formularëve dhe ndërtim pa leje. Mësohet se 44-vjeçari i përfolur më parë për trafik droge që prej disa vitesh kishte filluar ndërtimin për qëllime përfitimi të një objekti 10-katësh pa marrë më parë leje nga organet përkatëse. Sipas bluve, nga hetimet e kryera ka rezultuar se ky objekt me vlerë rreth 2 milionë euro është financuar nga paratë e siguruar përmes burimeve kriminale, ndërsa pallati në fjalë është vënë nën sekuestro preventive.

MASA E SIGURISË

Bardhok Pllanaj qëndroi vetëm pak ditë në burg pas arrestimit në dhjetor të vitit 2018, pasi gjykata e Shkodrës ndryshoi masën e sigurisë ndaj tij, duke e lënë duke e lënë në detyrim paraqitje pas komplikacioneve në zemër. Ai ka qëndruar rreth 3 javë në reanimacionin e spitalit të qytetit verior. Emri i biznesmenit do të lakohej për herë të parë në vitin 2014, gjatë operacionit policor "Laguna e Vilunit", ku u sekuestruan gati 1 ton hashash. 7 persona u arrestuan, por Pllanaj arriti t'i shmangej kapjes. Sipas PD në atë kohë, për t'iu shpëtuar prangave, trafikanti u fshih në automjetin e ish-deputetit Mark Frrroku, por ky i fundit mohoi akuzat.

vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

12) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 83 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

13) Pasuria ndodhur në Dobraq, apartament 317,5 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3200.

14) Pasuria ndodhur në Dobraq, njësi 198,5 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator dhe pronar i vetëm i shoqërisë "Old-B" shpk., sipas ref.3204.

15) Pasuria ndodhur në Dobraq, truall 922 m² në

pronësi të Bardhok Pllanaj si administrator sipas ref.3213 (kontratë këmbimi nr. 499/259, datë 12.02.2015 (mbi këtë truall pozicionohet objekti i legalizuar sipas ref.3200).

16) Pasuria ndodhur në Guci e Re, tokë arë 620 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj.

17) Pasuria ndodhur në Pulaj-Plazh, truall 8675 m² në pronësi të Bardhok Pllanaj sipas ref.2087.

II. PASURITË E LUAJTSHME

1) Automjet "Toyota Hilux", në pronësi të shtetasit Bardhok Pllanaj.

2) Automjet "Volkswagen Golf".

3) Automjet "BMW".

SHKURT

Pranga 45-vjeçarit me dy emra, i dënuar me

11 vite burg në Itali

ELBASAN - Një 45-vjeçar nga Çërriku ka përfunduar në pranga, me qëllim ekstradimitin drejt Italisë. Mësohet se specialistët për hetimin e narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan pas një pune të mirë organizuar, në bashkëpunim me blutë e Çërrikut dhe Interpol Tiranë arrestuan përkohësisht, me qëllim ekstradimitin drejt Italisë shtetasin shqiptar të shpallur në kërkim ndërkombëtar Jorgo (Gazment) Selmani, 45 vjeç, banues në Çërrik. Ndalimi i tij u bë pasi Gjykata e Barit në Itali e ka dënuar 11 vitet burg për veprën penale "Shkelje e ligjit mbi narkotikët".

Kapet 62-vjeçari, iu

vidhte portofolat të

moshuarve në Urgjencë

FIER - Policia e Fierit ka prangosur një 62-vjeçar, që ishte kthyer në tmerrin e pacientëve e të moshuarve në urgjencën e spitalit të këtij qyteti. Pas një pune hetimore njëmuore u bë e mundur kapja e autorit të dyshuar. Bëhet fjalë për Nikollaj Liçin, banues në Kuçovë. "Arrestimi i tij u bë pasi në Urgjencën e Spitalit Fier, ky shtetas dyshohet se në kohë të ndryshme ka kryer disa vjedhje, ku nga puna hetimore e deritanishme është bërë e mundur dokumentimi i tre prej tyre. Vijon puna për dokumentimin e rasteve të tjera të kryera nga ky shtetas.



KORÇË - Policia Kufitare në Kapshticë ka arrestuar me qëllim ekstradimitin drejt Gjermanisë një 36-vjeçar, pasi ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Bëhet fjalë për shtetasin D.P., i cili rezultoi i dënuar me 6 vite burg në Hamburg për veprën penale "Krimet që lidhen me drogën". Sipas policisë, ky shtetas në hyrje të kufirit shqiptar nuk deklaroi disa pajisje elektronike, me qëllim që të shmange detyrimet doganore. "Në hyr-

I dënuar në Gjermani për drogë, arrestohet 36-vjeçari në pikën kufitare të Kapshticës

je të Pikës së Kalimit Kufitar të Kapshticës, nga shërbimet e Policisë Kufitare në bashkëpunim me Interpol Tiranë është arrestuar provizorisht shtetasi D.P., 36 vjeç, lindur në Gjermani dhe banues në Greqi, pasi ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar, i dënuar me 6 vite burg nga

Gjykata Rajonale Hamburg, Gjermani, për veprën penale "Krimet që lidhen me drogën". Nga ana e shërbimeve të Policisë Kufitare të Kapshticës, këtij shtetasi i janë konstatuar edhe disa pajisje elektronike, të cilat ky i fundit nuk i kishte deklaruar në kufi, me qëllim shmangien e detyrimeve

doganore. Ndaj tij, specialistët e seksionit për Krimin Ekonomik referuan materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë për pajisjet e padeklaruar në kufi, si dhe u bë arrestimi provizor, me qëllim ekstradimitin drejt Gjermanisë", - thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Kush do të testohet në pozicionin infermier, fizioterapist, mami e teknik laborator

Voltiza Duro

Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listat e fituesve për Qarkun e Tiranës si dhe datat e testimit të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë. Përkatësisht janë 357 fitues në këtë qark për Infermierinë; 81 fitues për pozicionin mami; 57 fitues në Teknik Imazherie; 80 fitues për pozicionin Teknik Laboratori; dhe 89 fitues në Fizioterapi. "Testimi do të bëhet në Godinën e Lëndëve Paraklinike (pas spitalit infektiv) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për të gjithë për të gjitha qarqet", thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zbardhen emrat e 664 fituesve që aplikuan në 'Infermierë për Shqipërinë'

Kalendari me datat e provimit në fazën e dytë

DATAT DHE ORARI SIPAS QARQEVË DHE PROFILEVE:

- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profili Infermieri datë 9 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profili Infermieri datë 10 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 16 shkurt, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 17 shkurt, ora 12.00.

252	Stoli Gega	Tirane	infermier	9
253	SUADA JOVAN RRUSHI	Tirane	infermier	7.6
254	Subadi Selim Selimi	Tirane	infermier	9.6
255	Suela Duda	Tirane	infermier	6.4
256	Suzana Shaban Agolli	Tirane	infermier	12
257	Suzana Shabanaj	Tirane	infermier	8
258	Taulant Duka	Tirane	infermier	10.1
259	Teuta Skenderi	Tirane	infermier	7.5
260	Valbona Ndreva	Tirane	infermier	8
261	Valdete Ahmet Dulla	Tirane	infermier	6.7
262	Valentina Demail Toska	Tirane	infermier	24.8
263	Velide Pulomemoj	Tirane	infermier	8.5
264	Vera Hamdi Lleshi	Tirane	infermier	7.7
265	VILDANA ISMET RRINGAJ	Tirane	infermier	13.2
266	VINJOLA RAMADAN KOPANI	Tirane	infermier	16.3
267	Viosana Skender Gjoka	Tirane	infermier	7.3
268	Vitjola Servet Lika	Tirane	infermier	9.7
269	Vitorie Hekuran Biloshmi	Tirane	infermier	25.6
270	Vojtava Halilaj	Tirane	infermier	10.1
271	Voltina Midha	Tirane	infermier	8.4
272	Xheni Shira	Tirane	infermier	7.3
273	Xheni Hysej	Tirane	infermier	6.1
274	Xheni Stefan Stefani	Tirane	infermier	9
275	Xhensilda Engjellush Meminaj	Tirane	infermier	5.8
276	Xhoana Fadil Almadhi	Tirane	infermier	8.6
277	Xhulja Hysej	Tirane	infermier	6.3
278	Xhulja Xhevahir Osma	Tirane	infermier	9.2
279	Xhuljana Besim Shkreta	Tirane	infermier	6.6
280	Ylli Hasa	Tirane	infermier	13
281	Zaje Memolla	Tirane	infermier	9
282	Zamira Hysa	Tirane	infermier	7.4
283	Zamira Sami Ibra Abazi	Tirane	infermier	6.4
284	Olta Hebipari	Tirane	infermier	7.8
285	Blerina Tafani	Tirane	infermier	8.3
286	Matilda Jahori	Tirane	infermier	9.8
287	Enkeled Ajazi	Tirane	infermier	8.7
288	Aurela Qoshja	Tirane	infermier	10
289	Ada Gaci	Tirane	infermier	6.9
290	Deljada Sulce	Tirane	infermier	9.8
291	Klajdi Hysa	Tirane	infermier	8.4
292	Sotir Dinaku	Tirane	infermier	5
293	Deana Veizaj	Tirane	infermier	7.7
294	Jonida Dumitri	Tirane	infermier	8.7
295	Eriola Suli	Tirane	infermier	8.8
296	Marsena Hoxha	Tirane	infermier	9.3
297	Xhorxhina Shemilli	Tirane	infermier	9.3
298	Silva Kastrati	Tirane	infermier	9

299	Xhovana Jolla	Tirane	infermier	9.8
300	Blerita Rami	Tirane	infermier	21
301	Suida Malgioni	Tirane	infermier	7.4
302	Inva Peculaj	Tirane	infermier	9.6
303	Vera Mama	Tirane	infermier	8.7
304	Arbama Margjeka	Tirane	infermier	20.5
305	Erisa Pernga (Beqari)	Tirane	infermier	7
306	Mariola Manko	Tirane	infermier	6.8
307	Ermona Dodaj	Tirane	infermier	10
308	Marsela Dashi	Tirane	infermier	6.5
309	Ritvana Gjura	Tirane	infermier	10.2
310	Suzana Domi	Tirane	infermier	25
311	Xhuliana Karriqi	Tirane	infermier	7.8
312	Arjela Carga	Tirane	infermier	8.8
313	Pamela Velcani	Tirane	infermier	8
314	Antonela Kullolli	Tirane	infermier	8.6
315	Mereme Lusha	Tirane	infermier	7
316	Fatmira Sylaj	Tirane	infermier	9
317	Etleva Balla	Tirane	infermier	8.7
318	Rexhilda Rezi	Tirane	infermier	10.9
319	Fiqirije Dakuci	Tirane	infermier	7.5
320	Roberta Zoga	Tirane	infermier	8.4
321	Altin Kabili	Tirane	infermier	7.2
322	Pranvera Kazani	Tirane	infermier	8
323	Xhesika Muca	Tirane	infermier	10.2
324	Xhesina Mishtaku	Tirane	infermier	8.3
325	Kujtese Mustafaj	Tirane	infermier	6
326	Aroxhena Mara	Tirane	infermier	8.4
327	Xhemile Vidhishka	Tirane	infermier	10
328	Elisa Bitri	Tirane	infermier	8.1
329	Xheksina Gega	Tirane	infermier	8.2
330	Rivena Guga	Tirane	infermier	6.7
331	Anxhela Murra	Tirane	infermier	8.4
332	Ersa Boshi	Tirane	infermier	8.6
333	Drita Poci	Tirane	infermier	9.6
334	Robert Myrto	Tirane	infermier	6.5
335	Sara Papushallai	Tirane	infermier	9.5
336	Elvana Balla	Tirane	infermier	8.7
337	Rudina Jolla	Tirane	infermier	18.5
338	Selime Tocilla	Tirane	infermier	5.6
339	Votime Hasanaj	Tirane	infermier	7.4
340	Inesa Capo	Tirane	infermier	8
341	Jurgesa Belba	Tirane	infermier	7.9
342	Irena Lecini	Tirane	infermier	10.2
343	Enkeleda Muco	Tirane	infermier	5.6
344	Vanesa Abazi	Tirane	infermier	5.6
345	Xhevahire Haka	Tirane	infermier	7
346	Alma Brami	Tirane	infermier	8
347	Romina Gjini	Tirane	infermier	10
348	Gentiana Shahini Lala	Tirane	infermier	6.6
349	Sabina Shahu	Tirane	infermier	8.8
350	Artur Zani	Tirane	infermier	5.9
351	Pranvera Uka	Tirane	infermier	8.3
352	Frodela Dautaj	Tirane	infermier	7.6
353	Fatbardha Muca	Tirane	infermier	16
354	Marina Naco	Tirane	infermier	9.2
355	Donika Delia	Tirane	infermier	8
356	Irena Koci	Tirane	infermier	7.8
357	Amarilo Sina	Tirane	infermier	8.9

Qarku Tiranë Mami						
Nr	Emër	Atesia	Mbiemer	Qarku	Profesioni	Piket nga dosja
1	Adelajda	Nazmi	Varrosi	Tirane	Mami	7.8
2	Aida	Halil	Shehi	Tirane	Mami	11.8
3	Aida	Halil	Shehi	Tirane	Mami	10.8
4	Albina	Mustafa	Ismahili	Tirane	Mami	9.6
5	Albina	Skënder	Doka	Tirane	Mami	9.4
6	Alfrida	Xhaferr	Isaku	Tirane	Mami	9.1
7	Andia	Arben	Hoxha	Tirane	Mami	10.7
8	Anduela	Gezim	Imeraj	Tirane	Mami	8.2
9	Angjela	Hasan	Hyka	Tirane	Mami	8
10	Anila	Ferdinant	Xhaferr	Tirane	Mami	7.3
11	Anita	Laver	Hazizaj	Tirane	Mami	9
12	Anxhela	Thanas	Hysko	Tirane	Mami	9.5
13	Anxhelina	Viktor	Ramo	Tirane	Mami	7.8
14	Arjentina	Neim	Qefa	Tirane	Infermiere Mami	7
15	Arjola	Merkur	Toci	Tirane	Mami	5.1
16	Arta	Nikoll	Deda	Tirane	Mami	9.5
17	Brunilda	Petrit	Lala	Tirane	Mami	6.6
18	Dave	Gjin	Gjoka	Tirane	Mami	11.4
19	Denisa	Ismet	Hena	Tirane	Mami	9.5
20	Desiana	Dilaver	Llaka	Tirane	Mami	11.6
21	Edlira	Islam	Sida	Tirane	Mami	9.6
22	Elona	Dhimiter	Prifti	Tirane	Mami	9
23	Elona	Vait	Hasa	Tirane	Infermiere Mami	7
24	Emanuela	Clirim	Bashalli	Tirane	Infermiere Mami	7.8
25	Enalda	Ylli	Dollomaja	Tirane	Mami	9.3
26	Eni	Naim	Rrushoku	Tirane	Mami	9.7
27	Erjona	Avdyl	Morina	Tirane	Mami	12
28	Esmeralda	Elez	Dervishi	Tirane	Mami	7
29	Esmeralda	Albert	Sulo	Tirane	Mami	8.4
30	Evelina	Elmaz	Zaka	Tirane	Infermiere-Mami	10.9
31	Fabjola	Vait	Metkaj	Tirane	MAMI	8.5
32	Filmona	Arqile	Saliaj	Tirane	Mami	8.8
33	Fjona	Jorgo	Pasholli	Tirane	Mami	6.7
34	Fjoralda	Ndricim	Murati	Tirane	Mami	8
35	Gersjana	Gezim	Penxho	Tirane	Mami	9.7
36	Hasije	Dalip	Groshta	Tirane	Mami	21
37	Imelda	Agim	Mojsja	Tirane	Mami	7.3
38	Ina	Halil	Koljegja	Tirane	Mami	8.1
39	Jola	Petrit	Cela	Tirane	Mami	8.8
40	Jonida	Bashkim	Cani	Tirane	Mami	8.4
41	Jugerta	Shpëtim	Ismailati	Tirane	Mami	7.7
42	Leonora	Preke	Gjoni	Tirane	Mami	7.1
43	Leontina	Leke	Marku	Tirane	Mami	7.5
44	Lorena	Shefki	Kadiu	Tirane	Mami	11.4
45	Luljeta	Llambi	Parangoni	Tirane	Mami	6.9
46	Manushaq	Femi	Halili	Tirane	mami	6.8
47	Marinela	Vezir	Korcari	Tirane	Mami	8.3
48	Megi	Bashkim	Mana	Tirane	Mami	9.7
49	Merita	Remzi	Sina	Tirane	Mami	6.3
50	Mexhjana	Artur	Coniku	Tirane	Mami	9.8
51	Migena	Shefki	Kadiu	Tirane	Mami	9.5
52	Migena	Fadil	Mukaj	Tirane	Mami	9.3
53	Mirza	Nazim	Gjeli	Tirane	Mami	7.2
54	Nazjola	Skender	Beka	Tirane	Mami	9.2
55	Rigerta	Hasan	Hoxha	Tirane	Mami	9
56	Rukije	Idriz	Bulku	Tirane	Mami	9.5
57	Shpresa	Mustafa	Belba	Tirane	Mami	9.7
58	Silda	Ibrahim	Kola	Tirane	Mami	7.3
59	Sosina	Shahin	Datja	Tirane	Mami	8
60	Stela	Stefan	Pano	Tirane	Mami	6.7
61	Suela	Petrit	Gjuzi	Tirane	Mami	8.8
62	Valbona	Mehmet	Stani	Tirane	Infermiere Mami	9.1
63	Vitorie	Hekuran	Biloshmi	Tirane	Infermiere -Mami	27.1
64	Volteza	Telat	Midha	Tirane	Mami	8.5
65	Xhulia	Clirim	Muka	Tirane	Mami	9.8
66	Zojana	Bemjamin	Hafizi	Tirane	Mami	8.3
67	Enki	shefki	Dishani	Tirane	Mami	8.5
68	Andiola		Kumaraku	Tirane	Mami	9.3
69	Blerina		Balla	Tirane	Infermiere- Mami	7.5
70	Erisa		Shaba	Tirane	Mami	9.3
71	Manjola		Kuqi	Tirane	Mami	6
72	Lindita		Xhihenaj	Tirane	Mami	7.5
73	Drilona		Kortoci	Tirane	Mami	16

73	Drilona		Kortoci	Tirane	Mami	16
74	Jurgesa		Belba	Tirane	Infermiere Mami	7.9
75	Vanesa		Abazi	Tirane	Infermier-Mami	5.6
76	Sonila		Xhoxhi	Tirane	Mami	9.5
77	Johana		Heqimi	Tirane	Mami	7.2
78	Romilda		Torollari	Tirane	Mami	11
79	Brunilda		Alla		Mami	9.1
80	Albina		Daka	Tirane	Mami	8.4
81	Valona		Kasamaj	Tirane	Mami	7.5

Qarku Tiranë Teknik Imazherie					
Nr.	Emer	Mbiemer	Qarku	Profesioni	Piket nga dosja
1	Fluturim	Nela	Tiranë	Tek-Imazheri	16.7
2	Bujar	Kulla	Tiranë	Tek-Imazheri	12.5
3	Gerta	Halilaj	Tiranë	Tek-Imazheri	11.3
4	Silva	Malshi	Tiranë	Tek-Imazheri	10.8
5	Elona	Gode	Tiranë	Tek-Imazheri	10.5
6	Erjona	Cenkollari	Tiranë	Tek-Imazheri	10.3
7	Klotilda	Cera	Tiranë	Tek-Imazheri	10.3
8	Arjola	Dushku	Tiranë	Tek-Imazheri	10
9	Marije	Zefi	Tiranë	Tek-Imazheri	9.9
10	Klaudia	Xhikollari	Tiranë	Tek-Imazheri	9.8
11	Hyrie	Poreshi	Tiranë	Tek-Imazheri	9.8
12	Silvja	Canaliaj	Tiranë	Tek-Imazheri	9.7
13	Enxhi	Daci	Tiranë	Tek-Imazheri	9.7
14	Anisa	Bezati	Tiranë	Tek-Imazheri	9.6
15	Medina	Sulejmani	Tiranë	Tek-Imazheri	9.6
16	Anest	Zyka	Tiranë	Tek-Imazheri	9.4
17	Dajana	Bajaj	Tiranë	Tek-Imazheri	9.3
18	Katiola	Ismaili	Tiranë	Tek-Imazheri	9.2
19	Skerdi	Hoxha	Tiranë	Tek-Imazheri	9.2
20	Xhesika	Gllava	Tiranë	Tek-Imazheri	9.1
21	Adela	Plaku	Tiranë	Tek-Imazheri	9
22	Mirhat	Tocilla	Tiranë	Tek-Imazheri	9
23	Monika	Kojku	Tiranë	Tek-Imazheri	9
24	Violeta	Kallco	Tiranë	Tek-Imazheri	9
25	Erjon	Karaj	Tiranë	Tek-Imazheri	8.9
26	Zenel	Mulla	Tiranë	Tek-Imazheri	8.8
27	Xhulja	Toda	Tiranë	Tek-Imazheri	8.8
28	Zane	Mulla	Tiranë	Tek-Imazheri	8.7
29	Ersilda	Prendi	Tiranë	Tek-Imazheri	8.7
30	Lirije	Lila	Tiranë	Tek-Imazheri	8.6
31	Xhulia	Plaku	Tiranë	Tek-Imazheri	8.3
32	Klaudia	Ndoj	Tiranë	Tek-Imazheri	8.3
33	Kejvin	Shuka	Tiranë	Tek-Imazheri	8.2
34	Xhenisa	Balla	Tiranë	Tek-Imazheri	8.2
35	Benuada	Merko	Tiranë	Tek-Imazheri	8.2
36	Ardit	Derstila	Tiranë	Tek-Imazheri	8
37	Anxhela	Bushi	Tiranë	Tek-Imazheri	10
38	Marinela	Paluca	Tiranë	Tek-Imazheri	7.9
39	Rajmonda	Luga	Tiranë	Tek-Imazheri	7.6
40	Klajdi	Jaurri	Tiranë	Tek-Imazheri	7.6
41	Romina	Kanani	Tiranë	Tek-Imazheri	7.5
42	Ina	Tabaku	Tiranë	Tek-Imazheri	7.4
43	Eglantina	Iljazi	Tiranë	Tek-Imazheri	7.4
44	Marsel	Pustina	Tiranë	Tek-Imazheri	7.2
45	Malvina	Strazimiri	Tiranë	Tek-Imazheri	7
46	Dervish	Vrapci	Tiranë	Tek-Imazheri	7
47	Mikela	Haska	Tiranë	Tek-Imazheri	7
48	Orjada	Todhe	Tiranë	Tek-Imazheri	6.1
49	Frederik	Pjetraj	Tiranë	Tek-Imazheri	5.9

(vjon)

EKSPOZITA

Nga Luan Rama

Galeria 55^e e Bertrand Scholler ka ekspozuar këto ditë veprat e fundit të piktorit Bujar Luca në Rue de Bellechasse. Një galeri e një lloji tjetër: Bertrand është një ekspert arti, i cili kërkon të shohë tek artistët që ekspozojnë atë mision humanist aq të çmuar për shoqërinë. Dhe koncepti i tij i prezantimit të veprës së artistëve është disi ndryshe, duke ndryshuar nga ajo e kuratorëve të tjerë në galeritë parisiane. Disa ditë pas hapjes së ekspozitës, duke ftuar rreth tridhjetë njerëz të artit, piktorë, tregtarë arti, diplomatë e intelektualë të tjerë, rreth një kokteji ai i kërkoi çdo të pranishmi përshtypjet rreth ekspozitës dhe kjo duke u përqendruar në një temë të përcaktuar: "Deri ku arti piktural mund ta çlirojë fjalën?", dhe kjo në kuptimin se çfarë ndjen vizitori dhe si artikullohet kjo në fjalën e tij para një tabloje, ku gjykimet mund të jenë të ndryshme, veçanërisht kur kemi ballë me artin abstrakt, edhe pse në veprat e Bujarit gërshetohet dhe ana figurative me një ekspresionizëm spikates.

Shikojmë një nga tablotë e quajtura "Angelus" dhe një astronom ballë saj e vështron i mahnitur, pasi ajo tablo ka diçka hënore, me yje, si një hapësirë galaksie. Dhe vërtet ajo të çon në një botë tjetër ku referenca e Paolo Uçelo-s për mua nuk është e largët. Duhet të afroshesh një veprë, ta vështrosh gjatë, të ndjekësh linjat, ta "thithësh" me sy, atmosferën, ngjyrën e të prelesh në to për të folur pastaj për të, për të krijuar një dialog personal, të brendshëm, midis teje dhe tablosë. "E megjithatë, tablotë flasin vetë" - tha piktori i Jacques Pozzetto.

Nga viti në vit krijimtaria e këtij piktori duket se është në një kërkim të ethshëm, pasi edhe pse në një unitet stili e forme, ai kërkon shtigje të tjera. Bunkerin e kohës totalitare në "Black Box" duket se e ka lënë pas (një nga gjetjet më të bukura dhe simbolike të këtij piktori, të prezantuar në Paris apo në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë). Kështu, na u shfaqën dhe tablotë e këtyre 3-4 viteve të fundit, rozetat rrumbullake, ku peneli i piktorit duket se luan si gishtërinjtë e një pianisti virtuoz mbi tastierat e një pianoje, ku brenda tablove ka një dinamikë të jashtëzakonshme. Madje, në tablonë e parë që ka vendosur piktori në sifin e tij ai shkruan: "What time is it?" (Koha pa të cilën s'mund ta kuptojmë evolucionin njerëzor), duke luajtur kështu me ngjyrrat. Brenda hapësirës rrethore herë me të kuqe e herë në blu, të verdhë, jeshile, okër, duke ruajtur gjithnjë shenjat e akrepave të kohës. Ndoshta publiku para tyre e ka më lehtë të meditojë për kohën, botën, njeriun.

E njëjta ndjesi të ndodh kur kemi përballë pesë tablove të mëdha të serisë "Alphaimagique" një neologjizëm i krijuar nga vetë pik-



BUJAR LUCA

Tabotë që flasin vetë

tori duke afruar shkronjat e alfabetit me pikturën, gjestin piktural, një lloj alfabeti i pikturuar, ku imazhi është trajtuar figurativisht si shkronjë, çka na kujton hieroglifët e deshifruar nga arkeologu francez Champollion në "Rozetën e Aleksandrisë". "Është alfabeti i një gjuhe të gjallë-të vdekur dhe të jashtëkohshëm", - thotë Luca, edhe pse në një fare mënyre ne na rivijmë në kujtesë shkrimet e lashta figurative, duke vazhduar pastaj me kodikët e vjetër që u shfaqën që nga shekujt I dhe II të erës sonë, kodikë ku shkrimi dhe figura ishin arti i përkryer teksteve të shenjta dhe i kuptimit të botës. Ja pse dhe në bisedë, Bujari përdor termin "kodikë", për të treguar mbi këtë aventurë të bukur pikturale mjaft origjinale. Jo më kot na rishfaqen dhe një mori vizatimesh të Leonardo Da Vincit, elemente të studimit anatomik apo të shpikjeve të tij shkencore, imazhe të kërkimit për të kuptuar botën dhe ardhmërinë e saj.

SHQIPËRI MIDIS NESH

Në mbrëmjen këtij artisti, jo pak francezë ishin të lidhur me Shqipërinë, jo thjesht nga prania

"Deri ku arti piktural mund ta çlirojë fjalën?"



e ambasadorit shqiptar Dritan Tole, por sepse shumë prej tyre e njihnin shumë mirë vendin tonë. Emmanuel Rousseau, një nga miqtë e hershëm të Bujarit dhe i apasionuar pas pikturës së tij, ish-konsull i përgjithshëm në Kinë, apo i ngarkuar me punë a.i. në Shqipëri, (ku qëndroi katër vjet gjer

në periudhën e krizës së refugjatëve), kujtimet shqiptare janë të shtrenjta për të, duke folur me një dashuri të madhe për shqiptarët. Mes bisedës, ai na kujton dhe një detaj interesant kur kishte shkruar në Voskopojë dhe aty kishte gjetur një ish profesor të Liceut francez të Korçës gjatë viteve '30, i cili i kishte folur me shumë mall për epokën franceze dhe në fund, meqë ky kishte një mbiemër të njëjtën me filozofin e madh Jean Jacques Rousseau, i kishte dhuruar librin e famshëm "Kontrata sociale" që e ruante prej vitesh në bibliotekën e tij. Një tregtar i njohur arti, Xavier de Baume kujton-te historinë e një miku të tij, i cili më 1946 nga Korfuza ishte nisur me një varkë drejt bregut shqiptar dhe kishte mbetur fare pranë Sarandës. Por ushtarët e "Mbrojtjes Popullore" e kishin kapur si një "armik" dhe e kishin mbajtur dy vjet në burg, gjersa ambasada franceze mundi ta nxjerrë dhe ta nisë drejt Francës. Mark Hostier është një enciklopedist dhe kurator i jashtëzakonshëm i cili e njeht mjaft mire botën shqiptare, piktorët dhe letrarët, madje ishte ai që organizoi ekspozitën e mrekullueshme të Gazmend Lekës në Paris (të cilën fatkeqësisht nuk arrita ta shoh) si dhe një ekspozitë të Lucës në Torino. E përsëri ai mendon të ekspozojë piktorë të tjerë. E në këtë frymë nuk habitesh kur një piktor tjetër, Jacques Pozzetto, na ftoi në shtëpinë e tij dy hapa pranë, ku përsëri do të ishte e pranishme Shqipëria dhe kjo përmes pianistes Fatjona Matraku, mike e familjes, e cila mbi një piano të mrekullueshme interpretoi një nga pjesët më të bukura të kompozitorit Eric Satie "Gnossiennes"... Një shpirt shqiptar luante Satie...

E DIEL

3 Shkurt

2019



NGA LUAN RAMA

Para disa vitesh një kineaste bullgare kishte bredhur nëpër Ballkan në kërkim të origjinës së një kënge që e këndojnë shumë popuj të Ballkanit, shqiptarët, grekët, serbët, bullgarët, turqit, etj, dhe gjatë këtij itinerari ballkanik, kudo asaj i thonin se origjina e kësaj kënge ishte shqiptare apo greke, bullgare, turke, serbe, etj. Askush nga njerëzit nuk pranonte se kjo këngë ishte e një populli tjetër. Gjatë shkrimit të librit për konsullin francez, «Dozon, le consul qui aimait les contes albanais» («Dozon, konsulli që pëlqente përrallat shqiptare»), duke kërkuar origjinën e këngës «Konstandini i vogëlith», ashtu siç tregonte dhe Dozon, këtë këngë e kishin dhe popuj të tjerë. Por i shtyrë nga kureshtja, m'u desh ti drejtohesha epopesë bizantine të Digenis Aritas, dhe habia ime ishte e madhe, ndërkohë që dhe një studim i një studiuesi francez Rambaud në fundin e shekullit XIX, tregonte se kjo këngë ishte një epope bizantine. Pra ç'origjinë kishte kjo këngë? Sigurisht, shumë shqiptarë mund të habiten, por historia është kokëfortë, dhe ja se si...

Kënga e Konstandinit është padyshim një nga perlat e folklorit të Ballkanit dhe secili nga ne, që me tekstet e shkollave, është magjepsur me botën magjike dhe forcën e një krijimi që nuk mund të harrohet: është historia e fjalës së dhënë dhe e udhëtimit të një të vdekurit. Duke punuar për librin studiuesit francez dhe konsull në Janinë, (1869-1875) m'u desh të studioja dhe versionet e tjera të ngjashme ballkanike si dhe krijimin e poetit gjerman Gottfried August Bürger, *Leonore*. Madje, për shumë kohë kjo legjendë mbahej si një krijim popullor gjermanik. Sig-



HISTORIA e KONSTANDINIT të legjendës, e vërteta e madhe

urisht, poetët, shkrimtarët e apo autorë të tjerë të përrallave të legjendave popullore. Sidoqoftë, duke hyrë në botën e vet legjendës, kupton se ashtu si dhe në përrallat e vjetra, ato kanë shtegtuar nga një popull në tjetrin, brenda sferës ballkanike, si kultura të përafërta, edhe pse origjinale, duke marrë nga krijimet e njëri-tjetrit. Megjithatë, një gjë duket e sigurt:

kjo legjendë, ka si atdhe jo Perëndimin e as Lindjen e Largët apo të Afërt. Ajo ka si atdhe veçse Ballkanin!...

UDHËTIMI I TË VDEKURIT

Në vëllimin për këngët e pabotura bullgare, Dozoni i referohet këngës *Udhëtimi i të vdekurit*, apo, siç e shkruan ai, *Le voyage du mort*. Në të tregohet historia e një nëne me

nëntë djem dhe një vajzë, Vekia, të cilën ajo nuk donte ta martonte larg. Dimitri, i vetmi nga vëllezërit, pranon që e motra të shkojë e të martohet larg, pas nëntë pyetjeve të blertë. Të nëntë bijtë e nënës vdesin dhe një ditë Dimitri ngrihet nga varri për të shkuar dhe për ta marrë Vekian e për t'ia sjellë nënës së tij të vetmuar.

→Vijon në faqen 14

Redaktor: Ben Andoni. 373

Në këtë numër: THOMAS STEARNS ELIOT, LUAN RAMA, MAKS VELO, VIKTOR KOLIQI, SOKRAT PASKALI, TATJANA ÇOKU ETJ.

A

ARGUMENT

NGA LUAN RAMA

Vijon nga faqja 1

Në këngën serbe me të njëjtën temë, vëllezërit vdesin, sepse në vend ka rënë murtaja. Tre vjet kanë kaluar dhe Jelica është e martuar larg. E mërzitur, ajo pyet veten se ku janë vëllezërit e saj. Atëherë, Zotit i vjen keq dhe i dërgon dy engjëj që vëllai, i cili pranoi që motra të shkonte larg, t'i jepnin jetë. Dhe kështu, guri i varrit të Joanit u bë kalë, me dheun ai bëri ëmbëlsira për motrën e tij. Dhe kur shkoi ta marrë, ajo i tha: - Përse je i zbehtë, vëlla, sikur të kesh dalë nga dheu. Dhe vëllai i përgjigj: - Sepse punova dhe ngrita kulla për vëllezërit e mi... Jelica atëherë bën këmisha mëndafshi për vëllezërit e saj dhe ata u nisën. Kur iu afruan shtëpisë së nënës, ai i tha se do të ndalonte të kisha, sepse kur martohet i vëllai i kishite rënë unaza dhe se duhet ta kërkonte. Kështu ai shkoi dhe hyri në varr. Motra e priste, pastaj ajo e kërkoi dhe pa se rrotull kishës kishte varre, duke e kuptuar se ai ishte një i vdekur. Motra shkoi drejt shtëpisë, gjeti nënën, dhe i tha t'i hapte derën. - Ç'ke moj flamë e mallkuar, i tha nga brenda e ëma. - Ti më vdiqe nëntë djemtë dhe ja tani do të marrësh plakën e gjorë. Por Jelica iu përgjigj: - Hape, nënë, nuk jam flama e Zotit, por jam vajza jote, Jelica!... Ajo hapi derën, rënkuan të dyja si qyqe, u përqaftuan dhe ranë të vdekuara në tokë."

Dozoni, ka vazhduar krahasimin e versioneve të ndryshme ballkanike me versionin grek, të mbledhur në ishullin Hio, në shtëpinë e një fshatari. Ja çfarë shkruan ai:

"Nëna ka nëntë djem dhe një vajzë. Tetë vëllezërit nuk donin që e motra të martohet larg, por Konstandini kishte tjetër mendje: "Jepe, nënë, Aretën tonë në dhë të huaj, andej nga unë udhëtoj vazhdimisht që të kem një strehë dhe unë... Po nëna na ndodh një vdekje, një gjëmë, kush do ma sjellë bijën time? - Të betohem para Zotit e shenjtoreve që, nëse ndodh gjë, unë do të shkoj ta marr dhe do të ta sjell."

Areta martohet, kolera bie në ato anë. Nëntë vëllezërit vdesin dhe nëna mbetet vetëm. Në tetë varret, ajo gjetet gjoksën nga dhimbja. Te i nënti, ajo ankohet dhe ngre pllakën e varrit të Konstandinit: Oho, Konstandin, dhe më sill time bijë. Ti m'u betove para Zotit dhe shenjtëve që nëse do ketë zi apo gjajrë në shtëpi, ti do ta sillje. Ishte ky betim i bërë që e nxori atë nga varri. Reja u bë kalë, një yll iu bë shalë dhe hënën ai e mori si shoqëruese, duke lënë pas luginë e male. E gjeti motrën tek krihej në dritën e hënës. - Eja të shkojmë, Areta, se nëna kërkon të të shohë.

Kënga e Konstandinit është padyshim një nga perlat e folklorit të Ballkanit dhe secili nga ne, që me tekstet e shkollave është magjepsur me botën magjike dhe forcën e një krijimi që nuk mund të harrohet: është historia e fjalës së dhënë dhe e udhëtimit të një të vdekur.

Duke hyrë në botën e vetë legjendës, kupton se ashtu si dhe në përrallat e vjetra, ato kanë shtegtuar nga një popull në tjetrin, brenda sferës ballkanike, si kultura të përafërta, edhe pse origjinale, duke marrë nga krijimet e njërit-tjetrit. Megjithatë, një gjë duket e sigurt: kjo legjendë, ka si atdhe jo Perëndimin e as Lindjen e Largët apo të Afërt. Ajo ka si atdhe veçse Ballkanin!...

Kënga e Konstandinit dhe atdheu i legjendës

- Po si të vishem, o im vëlla, për zi apo për dasmë? - Eja kështu siç je!

Rrugës nga shkonin ata dëgjoniin zogjtë që këndonin: "Kush ka parë një të vdekur që ka pas vetes një vajzë të bukur? Më tutje, të tjerë zogj këndonin: "Oh, ç'dhimbe, një i gjallë që shkon me një të vdekur!" - Ç'thonë kështu këta zogj? - i thotë e motra. - Eh, zogj janë... - Kam frikë nga ty, im vëlla, se ti vjen erë temjani. - Dje ishim në kishën e Shën Gjoni dhe prifti hodhi shumë temjan. Dhe ata vazhduan rrugën. Zogjtë këndonin: Ç'gjë të çuditshme ke bërë, o Zot, një vajzë e bukur me një të vdekur shkon! ... Dhe zemra e Aretës u plagos: - A e dëgjon, Konstandin, se ç'thonë zogjtë? Thuamë, ku i ke flokët? Po mustaqet t'nde të dendur, ku e ke? - Kam vuajtur, motër, nga një sëmundje e rëndë dhe desh vdiqa. Flokët më ranë, e po kështu dhe mustaqet.

Dhe ata e gjetën shtëpinë e nënës të mbyllur me kyç, ndërsa dritaret mbuluar nga merimangat. - Hapma derën, nëna ime, jam Areta! - Nëse je ti, Koron i vdekjes, vazhdo udhën tej, pasi s'kam më fëmijë. Areta ime e shkrete është në dhë të huaj. - Hape derën, nënë, jam unë, Konstandini. Isha betuar përpara Zotit dhe shenjtoreve



djemtë nuk e pranuan kërkesën e tij, sepse ai vinte nga shumë larg. Vetëm Konstandini pranoi dhe donte që martesa të bëhej: - Nënë, pranjo këtë martesë. - Konstandin, biri im, ç'thuhet kështu, ti do që motra tënde të shkojë aq larg? Po të kem ndonjë gëzim, një nevojë në ditë zije, ajo do më mungojë. - Atëherë, nëna ime, unë do shkoj

Kënga edhe për popuj të tjerë

Gjatë shkrimit të librit për konsullin francez, "Dozon, le consul qui aimait les contes albanais" ("Dozon, konsulli që pëlqente përrallat shqiptare", duke kërkuar origjinën e këngës "Konstandini i vogëlith", ashtu siç tregonte dhe Dozon, këtë këngë e kishin dhe popuj të tjerë. Por i shtyrë nga kureshtja, m'u desh t'i drejtohesha epopesë bizantine të Digenis Aritas dhe habia ime ishte e madhe, ndërkohë që dhe një studim i një studiuesi francez, Rambaud, në fundin e shekullit XIX tregonte se kjo këngë ishte një epike bizantine. Pra ç'origjinë kishte kjo këngë? Sigurisht, shumë shqiptarë mund të habiten, por historia është kokëfortë, dhe ja se si...

ta marr!

Dhe Garentina u martua. Por pas kësaj ndodhi një vit i tmerrshëm që i kositi të nëntë vëllezërit e saj në fushën e betejës. Dhe nëna u vesh me të zeza dhe e mbylli shtëpinë.[2]

Të shtunën e të vdekurve ajo doli dhe shkoi në kishë, ku ishin varret e djemve të saj dhe në secilin varr vendosi nga një qiri dhe vajtoi. Ndërsa në varrin e Konstandinit ajo vuri dy qirin dhe vajtoi dy herë.[3]

Kur mbrëmja ra dhe kisha u mbyll, nën dritën e qirinjeve, Kon-

standini u ngrit nga varri. Pllaka e gurtë e varrit iu shndërrua në një kalë të furishëm, mbuluar me një pelerinë të zezë. Ai u hodh mbi kalë dhe u nis me galop. Dielli ishte ngritur, kur ai mbërriti në kullën e shtëpisë. Në oborrin e madh ai gjeti fëmijët e saj që lozin duke ndjekur dallëndyshtet. - Ku është nëna juaj? - i pyeti ai. - Daja ynë Konstandin, nëna ka shkuar të hedhë valle në qytet.

Dheai shkoi drejt njerëzve që vallëzonin. Iu afrua vajzave të bukura dhe i pyeti: - A është me ju motra ime, Garentina? - Shko më tej se do ta gesh me rroben e saj të shkëlqyer dhe kapelen prej veluri. Pastaj iu afrua valles së dytë që hidhej: - Konstandin, vëllai im! - Garentinë, lëre vallen dhe eja të shkojmë. Do shkojmë në shtëpinë tonë. - Po më thuaj, ç'të bëj, sepse në shkoj për zi, të vishem me të zeza, dhe nëse shkoj për gëzim, të marr rrobat e festës. - Eja të shkojmë kështu siç je.

Dhe ai e vendosi atë mbi kalë. Kishin kohë që shkonin kaluar, kur Garentina i tha: - Konstandin, vëllai im, shoh një shenjë vdekjeje, sepse supet e tua janë mbuluar me myk. - Garentinë, motër, është tymi i pushkëve që i ka bërë kështu supet e mia. - Por shoh dhe diçka tjetër, pasi flokët e tu me onde tashmë janë kthyer në pluhur. - Garentinë,

motër, të gënjejnë sytë, pasi ky është pluhuri i rrugës. - Konstandin, im vëlla, përse vëllezërit e tu të dashur dhe kushërinjtë nuk i shoh të na presin? - Ata do të jenë atje tutje. Por ne ndoshta po mbërrim vonë dhe ata s'na presin. - Por tjetër gjë po shoh, o im vëlla, dritaret e shtëpisë sonë janë mbyllur dhe barërat i kanë mbuluar. - Ah, nëna i ka mbyllur ato nga erërat e detit, sepse nga kjo anë fryn flidi i dimrit.

Duke mbërritur, ata kalojnë pranë kishës. - Lermë të shkoj në kishë të lutem! - i thotë Konstandini... Duke ngjitur shkallët e larta, ajo shkoi drejt derës së nënës së saj. - Hape derën, nëna ime! - Kush je ti që troket në derë? - Zonja mëmë, jam unë, Garentina! - Shko tutje moj hienë e vdekjes, që më more nëntë djemtë dhe tani, me zërin e vajzës sime, vjen të më marrësh dhe mua. - Oh, hape, zonja mëmë, jam unë vetë, Garentina. - Po kush të sollti këtu, bija ime? - Konstandini, im vëlla! - Po ku është ai tani? - Ka shkuar të lutet në kishë.

Nëna hapi derën dhe shtrëngoi bijën e saj në krrahë, e bija shtrëngoi nënën dhe nënë e bijë dhanë shpirt."

Pikërisht në këtë periudhë Dozoni u njoh edhe me shkrimet e Dora d'Istrias të botuara në revistën e famshme Revue des Deux Mondes. Më 1865, ajo kishte botuar në këtë revistë studimin mbi këngën popullore serbe, ndërsa një vit më vonë, po në këtë revistë ajo kishte botuar studimin Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore (La Nationalité albanaise d'après les chants populaires). Në këtë studim Dozoni i bëri përshtypje të veçantë njohja e thellë prej kësaj intelektualjeje me origjinë shqiptare e folklorit ballkanik, e në veçanti atij shqiptar. Madje në një nga shkrimet e tij, ai nuk lë pa përmendur edhe punën e lavdërueshme të zonjës Dora d'Istria. Në fakt, që në fillim të studimit të saj, ajo kishte vendosur referencat që ishin në bazë të këtij studimi, emra të tillë si: D. Camarda, Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese (Livourne 1865); H. Dr. G. deHahn, Chants tosqes et Proverbes tosqes, dans Albanische Studien (Vienne 1853); - Griechische und albanische Mœrenhe (Leipzig 1864); G. Petta, Piana dei Greci nella Rivoluzione siciliana del 1860 (Palermo, 1861). H. Hecquard, His-

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri duhet thënë se ishte bërë në frymë inercie. Redaktori, për shkak të një problemi madhor familjar, nuk mund të ishte shumë korrekt me numrin e tij të radhës. Për fatin e madh, genësia e një ekipi të mirë (në fakt dy persona), që bënë "Milosao" funksionoi deridiku mirë. Gjithsesi në fund na u rrëfën gabime të shumta. I pari profesor Bardhyl Demiri me skrupulozitetin e tij natyral ishte i pakënaqur me ngjijen e disa fragmenteve, që ndodh kur ruhet mesazhi në Word-in e avancuar. Kritika ishte e drejtë dhe redaktori u tërhoq duke premtuar që në këtë numër ta shprehë. Shkrimi i tij ishte shumë i ndjerë dhe i kushtoj profesor Idriç Ajetit. "Lejohej të kumtoj me këtë rast thjesht përvojën time personale, pikërisht mënyrën se si e kam përjetuar, ndonëse me shumë vonesë (!) - atë angazhim social të profesor Ajetit në shkrimet e tij përgjatë rrethit të procesit të normëzimit të variantit të shkruar të Zonjës Shqipje", shkroi ai.



Tadeush Ruzević, që mendon se janë të mira, por edhe për të përgatitur publikun për botimin e veprës së tij, që mban përkthyes të poezive vetë redaktorin dhe të eseve Astrit Beqirin. Albumi "Magazina e komunistit shqiptar" i autoreve Elektra Haxhia Çapaliku, pati problemin e mungesës së kopertinës dhe në këtë rast kështu edhe u pagëzua me publikun... Muzikologu Sul Gragevi erdhi bashkë me një mikun e tij në natyrën e vet të zakonshme të shkrimeve përkujtimore për personalitete muzikore, por që i jep një frymëmarje shumë të vlerësueshme "Milosao". "Mstislav Rostropovic, u cilësua si një nga personalitetet botërore të drejtave dhe lirive humane të artistëve. Raporti i nismëtarit të Peshtrëkës Mihail Gorbaçov, me Rostropovicin dhe Vishnevskajin ishte i ndryshëm, por megjithatë, Rostropovic e simpatizoi njeriun i cili i lejoi vendit të marrë frymë më lirshëm, duke hedhur tutje frikën e arrestimeve dhe të internimeve. Kontakti me miqtë filloi ngadalë, duke u përfunduar në shkollën e muzikës në Moskë, shkroi ai mes të tjerave. Faruk Myrtaj na solli një tregim të titulluar "Bllok i bukur mermeri" duke na sjellë një punë të mirë në formë por edhe në menaxhimin e duhur të paradoksit, referuar autorit. Duhet thënë se e bërë në kushte të tilla "Milosao" ishte relativisht e mirë dhe layout duhet vlerësuar...

toire et Description de la Haute-Albanie ou Guegarie: V. G. Crispi. Chants des Albanais de Sicile, en albanais, dans Vigo, Cantù pop. Sicil. (Catane 1849); V. Dorsa, Poesia popolare - Su gli Albanesi ricerche e pensieri (Naples 1847); A. Masci, Discorso sull' origine, i costumi, etc., Naples 1847; G. de Rada, Poesies albanaises, en albanais, (Naples 1836); Chants de Séraphina-Thopia, princesse de Zadrina au quinzième siècle, en albanais, (Naples 1843).

Pra, këta ishin studiuesit e burimet themeltare ku Dozoni duhej të mbështetej më vonë për studimet e tij rreth folklorit shqiptar dhe gjuhës shqipe. Dhe kjo punë këmbëngulëse s' do të vononte... Po nga Bleta shqiptare, por në versionin shqiptaro-italian, pra, arbëresh, Dozoni kishte gjetur dhe përkthyer dhe Këngën e Konstandinit, Konstantin, le mort voyageur, duke bërë njëkohësisht përqasje interesante dhe me variantin e botuar nga Dhimitër Kamarda, Kostantini e Garentina, të cilën e kishte regjistruar ndër arbëreshët e Kalabrisë, ku, ndër të tjera, shkruhej:

"Bila ime, kush të suallë? / - Kostantini ertë e më suallë. / - Kostantini eni ku vate? / Vate hiri në qishë. / - Kostantini po po bile / Kostantini u bë botë. / Tue qaiturë, ture u puthurë / U shtrënguan u jëma e e bila / e aqë helmi, aqë taraksia / sa vëdiq e bila e e jëma. [4]


Epika shqiptare ruan edhe Këngën e Halil Garisë, të botuar gati një shekull më parë në Visaret e Kombit ku këtë legjendë e gjejmë në një formë tjetër të ngjashme dhe ku Halili është njëri nga nëntë vëllezërit, i cili i ka dhënë fjalën të motrës që do ta merrte edhe pse 9 ditë rrugë larg. Kur motra pa se Halili s' kishte ardhur sipas fjalës së dhënë, i kërkoi një zogu që të shkonte dhe t'i kujtonte Halilit besën e dhënë. "Amanet, more zogu malit! / Mi thuej vllaut, Halilit të ri, / Se jot motër mue më ka thanë: / - Ku e le besën, q' m'ke dhanë?... / Por në fakt, vëllezërit ishin vrrarë me njëri-tjetrin dhe ja ku pas 7 vjetësh mrekullia ndodhi. Halili u çua nga varri dhe shkoi të marrë motrën e tij dhe kur e solli atë, menjëherë u zhduk. Nënë e bijë takohen, shkon tek varret e djemve dhe aty vdesin nga dhimbja.

Në shkrimet e tij Dozoni shpreh se në bazë të kësaj ballade të bukur u krijua më pas dhe ballada e famshme e Lenore-s (Leonorës), e Bürger-it[5] "dhe fama e këtij



tregimi gjerman bëri të flitet për pararendësit e tij... "Në Shqipëri, - shton ai, - nuk është e rrallë të shohësh një burrë që ka toka si pronë, por që ikën nga shtëpia e tij dhe bën ekspedita të largëta për të fituar..." Dhe njëkohësisht ai pyet: "Cili është origjinali?... Ai nuk është në një mendje me studiuesin gjerman Fullmerajer (Fallmerayer) sipas të cilit shqiptarët janë prioritarë në krijimin e legjendës "Udhëtimi i të vdekurit", "Voyage du mort". Në fakt, më shumë se popujt e tjerë fqinj, shqiptarët e perandorisë otomane ishin të detyruar të shkonin nizamë gjer në territoret më të largëta të perandorisë, në Liban, Siri apo Jemen e gjer në Palestinë. Është e njohur kënga e tyre "Mbeçë, more shokë, mbeçë / përtej urës së Kia-besë..." Kënga Kostandiniit vogëlith gjendej apo këndohej pak a shumë në gjithë diasporën shqiptare:

"Konstantini i vogëlith / tri ditë dhëndërit; / perënduar tri ditë / me nusen e re, të re, / e i erdh karta



e zotit madhë, / ai të vejë nd'ushtaratë..."

Në studimin e saj Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore (La nationalité albanaise d'après les chants populaires), botuar në frëngjisht që në vitin 1866, në Revue des Deux Mondes, Dora

D'Istria i referohej gjatë kësaj kënge të mbledhur njëkohësisht nga Dorsa dhe Krispi, një këngë që tregonte për shqiptarët në kohën e Bizantit. Ja si e botonte Dora d'Istria këtë legjendë:

"Gjatë tri ditëve kam parë një ëndërr / Konstantini im i vogël / Perandori i kishte kërkuar të nisë në luftë. / Djaloshi fisnik / mori leje nga unë dhe nëna e tij e dashur / dhe pastaj nga e shtrenjta e tij / me të cilën kish lidhur unazë / së cilës para se të shkonte i tha: / "Lamtumirë, bukuroshja ime e shtrenjtë, / Do të jem larg nëntë vjet, nëntë muaj e nëntë ditë. / Dhe (nëse nuk kthehem), ti gjej një tjetër burrë. / Kaluan kështu nëntë vjet / nëntë muaj e nëntë ditë / dhe bukuroshja u bë e fejuara e një tjetri. / Dhe të djalë e ardhshme i dha dorën..."

Por natën e kësaj fejeje, - siç shkruan Dora d'Istria, - poshtë tendës së perandorit, në mes të natës, u dëgjua zhurma e një psherëtime aq të madhe, sa të gjithë u zgjuan nga gjumi. Kur erdhi mëngjesi, perandori u ngrit nga shtrati dhe u dha urdhër t'u binin daulleve, duke mbledhur rreth tij fisnikët dhe luftëtarët. - Më thonin, zotërinj, cili nga ju psherëtiu mbrëmë gjatë natës?... Të gjithë heshtën, kur ndërkohë Konstantini u përgjigj: - Jam unë ai fatkeq që psherëtiu. - Për kë kështu? - Psherëtime ime shkoll larg, madhëri. - Konstantin, i shtrenjtë im! Shko te stalla e kuaeve dhe midis tyre zgjidh kalin e zi si ulliri, ose atë që është i bardhë si pëllumbi, apo atë

që është i shpejtë si gjerajina. Konstantini mori leje, zgjodhi kalin e shpejtë si gjerajina, i hipi dhe u dha yzengjive. Ditën e dasmës, i ati i tij i mjerë po largohej nga ai vend dhe rrugës takoi Konstantinin që kishte qenë fejuar veç tri ditë. - "Mirëdita, o plak / ku po shkon kështu?" - "Ah, mos folë, se më kujton tim bir / - Kam patur një djalë që e quanin Konstantin / Konstantini, im bir! / E kam parë në ëndërr gjatë tri ditëve / Perandori më urdhëroi ta dërgoja në luftë..."

Pas një përsëritjeje homerike të ngjarjeve të kënduara në fillimin e këngës, poeti shton:

"Dhe e bukura e tij u fejuaj / Ajo do jepte dorën të djalë / Ta kam thënë, o ati im plak / që pas pak Konstantini do të vijë / - Oh, për një lajm kaq të lumtur, t'i kesh ditët e gjata e të lumtura! / Konstantini erdhi të djalë / erdhi në qytet që herët në mëngjes. / La aty vezmen e tij / dhe shkoi në derën e kishës / dhe aty vendosi flamurin e tij / E çfarë, ndoshta ju nuk më donit për kumbarë të dasmës / Ju prindër, fisnikë dhe gjithë sa jeni? / Qofsh i mirësardhur, o i huaj! - o djalosh beqar!"

Në çastin kur Konstantini i vë unazën të dashurës së tij, ajo e njohu.

"Dhe si fletë e trëndafilut ubë fytyra e saj / dhe gjoksi iu mbush me pika të kuqe / Konstantini e pikasi dhe thirri / O prindër, dhe ju o fisnikë / Konstantini ka ardhur / Dhe ai e pushton vajzën e tij / Ju pëlqen apo nuk ju pëlqen / bukuroshja është e imja / e atij që ishte i fejuari i saj i parë."

Megjithatë, pa arritur në konkluzione për përparësinë e njërit version nga tjetri, pra i krijimit fillestar nga njëri popull ballkanik apo tjetri, le t'i drejtohem dhe versionit gjerman të kësaj legjende ballkanike të poetit Bürger, që fillimisht u përkthye në frëngjisht nga poeti i njohur francez Gérard de Nerval. Ja çfarë shkruhet në këtë tregim të Bürger-it:

Léonore (Leonore)

Pas ëndrrash të trishta, Leonora ngrihet që në ag: "Vilhelm, burri im! Vallë ke vdekur? Apo e ke shkelur betimin e bërë? Vallë ende do të vonohesh?"

Që atë natë që ishin martuar, ai ishte nisur për në betejën e Pragës, duke ndjekur pas mbretin e tij Frederik; dhe qysh atëherë, nuk kish-

→ Vijon nga faqja 15

te sjellë asnjë lajm për shëndetin e tij. Por mbreti e mbretëresha, të lodhur nga grindjet e përgjakshme, duke u paqtuar pak nga pak, më së fundi përfunduan paqen. Dhe nën tingujt e timbaleve e të fanfarave, "kling", "klang", duke vënë në koka gjethet e dafinës, secila ushtri u kthye në mbretëri të e vet.

Dhe kudo, papushim, mbi rrugë e mbi ura, të rinj e pleq takohen me njëri-tjetrin. "O Zot, qofsh lënduar!", thërret çdo fëmijë e grua. "Mirë ardhsh!" - thërresin të fejuarat. Por mjerisht, e vetme, më kot Leonora pret puthjen e kthimit prej Vilhelmit. Ajo vërtitet mes njerëzve dhe pyet ngado, por nga të gjithë ata që janë kthyer, askush s'mund t'i japë lajme të reja për burrin e saj të shtrenjtë. Dhe meqë ai është larg, ajo nis të shkëlë flokët dhe të plasat për tokë duke u dridhur në delir. Nën shikon me nxitim drejt saj: "Ah, Zoti të ndihmoftë! Ç'ke, o fëmija im i shkretë? - dhe ajo e shtrëngon në krahët e saj. "Oh, moj nëna ime, ai ka vdekur! U shohtë kjo botë, u shohtë kjo gjithë. Zoti s'ka më hiç mëshirë! Oh, e mjera unë, e mjera unë!"

"Zoti na ndihmoftë e na mëshiroftë! Vajza ime, lutju Atit tonë. Ajo çka ai bën është gjithnjë në të mirë, dhe asnjëherë ai nuk ka munguar të na ndihmojë."

"Oh, moj nënë! Ti gabohesh, Zoti më ka braktisur; përse kanë shërbyer lutjet e mia, përse?"

"O Zot, ki mëshirë për ne! Ai që njeh Atin, e di mirë që ai nuk i braktis fëmijët e tij: At ishenjtë, pagtoi gjithë dhimbjet e tua!"

"Oh moj nënë, moj nënë! Asnjë sakrimnt nuk mund t'ua kthejë jetën të vdekurve!"

"Zoti im! Ki mëshirë për ne! Mos e gjyko vajzën time të gjorë. Ajo nuk di se ç'thotë. Mos ia merr si mëkate. Vajza ime, harroji dhimbjet tokësore, mendo për Zotin dhe lumturinë qiellore, që burri të jetë në qiell!"

"Oh nëna ime, ç'është lumturia? Ç'është ferrri? Lumturia ime është vetëm me Vilhelmin, ndërsa pa të është vetëm ferrri! Shuaju, ti o flakë e jetës sime, shuaju në tmerin e errësirave! Zoti s'ka aspak mëshirë... Oh, sa fatkeqe që jam!"

Kështu, dëshpërimi i skajshëm hapte plagë në shpirtin e zemrën e saj dhe e bënte të shante mirësinë e Zotit. Ajo godiste gjoksin dhe ndrydhte gjymtyrët gjër në perëndim të diellit, deri në çastin kur yjet e praruar u shfaqën në kupën e qiellit. Ndërsa jashtë bëhet zhurmë. Trap, trap, trap... duket si hapi i një kali. Ngjan se një kalorës zbrit përmes zhurmave të mburojës së tij. Dëgjoni... dëgjoni... Zijla tingëlton lehtë... "klingklingling"! Dhe përmes derës një zë i ëmbël depërton:

"Hola! Hola! Hapma derën fëmija im! Zgjuar je apo po fle? Po gëzon apo po qan?" - "Ah Vilhelm, kenke ti? Kaq vonë nëpër natë? Po rrija zgjuar dhe qaj... Oh, kam vuajtur tmerrësisht. Nga po vjen, kështu, me kalin tënd?"

"Ne u hipim kuajve veç në mesnatë. Po vij nga thellësia e Boheemisë. Ja pse kam ardhur kaq vonë, të të marr me vete." - "Ah, Vilhelm, s'pari hyrë brenda, sepse era e pyllit po fërshëllen."



Kënga e Konstandinit dhe atdheu i legjendës

"Le të fërshëllejë era në pyll, ç'rëndësi ka?.. Kali gërryen tokën, këmbëzat e tij bëjnë zhurmë. "Nuk mund të rri këtu. Eja Leonorë, vishu dhe hidhu në kurriz të kalit tim, se kemi njëqind lega për të bërë deri sa të shkojmë në banesën tonë."

"Po si kërkun të nisësh e të bësh njëqind lega që sonte për të shkuar në shtëpinë tonë? Dëgjo, këmbana e mesnatës ndihet ende." - "Vështro, vështro si shkëlqen hëna! Ne dhe të vdekurit... të shkojmë shpejt. Dua të të çoj që sonte."

"Pa thuama, ku është banesa jote? A ka vend për mua?" - "Ka për të dy ne. Eja Leonorë, hidhu mbi kalë. Banketi i dasmës është përgatitur dhe të ftuarit na presin."

Vajza vishet e hidhet mbi kalë. Ata shkojnë: hop, hop, hop, dëgohet jehona e galopit. Kali dhe kalorësi mezi marrin frymë. Nën hapat e tyre, gurët nxjerrin xixa. Djathtas e majtas, gjatë rrugës së tyre parakalojnë me shpejtësi lëndinat, pyjet, fshatrat... dhe urat nën hapat e tyre kumbojnë. "A ka frikë e dashura ime?" "Hëna shkëlqen, hurra! Të vdekurit shkojnë shpejt! Vallë, ka frikë ajo nga të vdekurit?" - "Ah, lëri të vdekurit në paqe!"

"C'janë atje tutje ato zhurma e këngë? Ku shkon ajo re korbash? Dëgjo... është zhurma e një këmbane. Janë këngë funeralësh." "Kemi një të vdekur për të varrosur." Dhe karvani afrohet e shogërohet nga këngët që ngjajnë me gjuhën e rëndë të bujtësve të kënavëve.

"Pas mesnate, trupin ua mbulojnë bashkë me vajet dhe këngët e dhimbshme. Unë do të çoj nusen

time dhe ju ftoj në sofrën e dasmës sime. Eja, afrohu me korin, dhe nisja himnit të fuqishëm të martesës. Eja, prift, ti do të na beko-sh!" Vajet e këngët kanë heshtur. Birra ka mbaruar.

Të prekure prej ftesës së tij, të gjithë e ndjekin në kalin. Hurra! Hurra! Ai shtrëngon kalin dhe hop, hop... dhe tutje dëgohet galopit të tij. Kali dhe kalorësi mezi marrin frymë dhe gurët poshtë nxjerrin xixa. Djathtas e majtas kalojnë fluturim imazhet e kodri-nave, pyjeve, fshatrave. Majtas e djathtas shkojnë qytetet e qytetet. "A ka frikë mikja ime? Hëna shkëlqen, hurra! Të vdekurit shkojnë shpejt! Vallë, ka frikë ajo nga të vdekurit?" - "Ah, lëri të vdekurit në paqe!"

"Pa shih, a shikon pranë atyre trikëmbëshave hijet ajrore që hëna e argjendit i bën të dukshme? Ato hehjin valle rreth tyre. Hej, figura të këndshme, afro-huni, ndiqmëni pas që të hidhni valle në vallen e dasmës sonë... Po shkojmë në një banket të gëzuar..."

Hush, hush... gjithë ajo tutje lëshohet pas tyre, ashtu me zhurmën e erës, mes gjetheve të thara: pastaj përpara, përpara! Hop, hop, hop, jehon galopit i kalit. Kali dhe kalorësi mezi marrin frymë dhe, nën hapat e tyre, gurët lëshojnë xixa. Oh, si fluturojnë, si

fluturojnë aq larg, ndërkohë që hëna ndriçon gjithçka përreth. Qielli dhe yjet shkojnë sipër kokave të tyre. "Vallë, ka frikë e dashura ime?" Hëna ndriçon... hurra!" Të vdekurit shkojnë shpejt... "O Zoti im! Lëri në paqe të vdekurit!"

"Guxim, kali im i zi. Më duket se gjeli i mëngjesit po këndon. Koha më së fundi do të mbarojë. Ndiej erën e mëngjesit. Nxito, ti kalim! Po përfundon, po merr fund vrapin ynë, shpejt! Po shoh banesën tonë... Të vdekurit shkojnë shpejt... Dhe ja, më në fund po arrijmë!"

Ai hidhet vërtik kundër një grille hekuri dhe kalin e godet me një të rënë kamzhiku. Hekurat thyhen... të dy tërhiqen duke rënkuar: Vulli i kalit e con midis varreve, të cilat, nën shkëlqimin e hënës, duken ngado. Ah, e sheh?!... por në të njëjtin çast ndodh një çudi e tmerrshme... Ai bie e zhduket në thellësitë e tokës: ulurimat zbresin nga hapësirat ajrore, rënkimet ngrihen nga varret e nëndeshme... Dhe zemra e Leonorës përpëlitet midis jetës e vdekjes. Dhe shpirtat, në qartësinë e hënës mblidhen rreth saj dhe vallëzojnë duke kënduar: "Durim! Durim! Kur dhimbja thyen zemrën

nënës bëri që Konstandini të ngrihet nga varri. Gurri i varrit iu bë kalë dhe tokai u bë shalë, flokët e verdhë iu bënë kapistall dhe krimbi i tokës u kthye në vetë Konstandinin. Dhe ai nxitoi drejt Eudocies. E merr atë me vete mbi kalin dhe gjatë udhës së kthimit zogjtë e vegjël këndojnë: "Si vallë është e mundur që të gjallët të shkojnë bashkë me të vdekurit?" Eudocie fillon të ketë frikë por vëllai i saj e siguron. Në afërsi të shtëpisë së tyre Konstandini zhduket. Endocie bie në krahët e nënës së saj dhe ky përfaqim është i fundit, sepse pastaj atë e varrosin të vdekur në dheun me merimangat që bëjnë pëllhurën e tyre". Siç thotë Legrand, "Në gjuhën greke ekzistojnë disa variante të kësaj kënge. Ne kemi gjetur variante dhe tek shqiptarët e serbët. Zoti Dozon sapo ka botuar një tekst të tillë të bullgarëve. Dhe së fundi: gjithë bota e njeh versionin gjerman: "Të vdekurit shkojnë shpejt!"

Rambaud n'a kujton gjithashtu se Akritas (d.m.th. rojatar ku-firi - akras), është pinjoll i dy racave: ai është grek, pra një Dukas nga e ëma, bijë e Andronikut, dhe musliman nga i ati, emir i Edesse dhe se ndoshta rrënjët e kësaj po-

eme anonime të Trebizontit të shekullit XIV "vijne nga koha kur kryqtarët e shekullit XIII gjejnë shumë ngjashmëri me stratotët grekë dhe baronët e Perëndimit, dhe se shkrimja e këtyre dy shtresave fisnike u bë menjëherë. Kronika franceze e Moresë nuk heziton tu japë luftëtarëve indigjenë titullin fisnik, ndërsa ata, në gjuhën e tyre i cilësojnë kryqtarët frankë estradiotë apo kalorës". Bëhet fjalë për një dorëshkrim të historisë së Digenis Akritas ku mungon libri i parë, gjysma e të dytë apo një fletë e të shtatit, etj. Rambaud nuk heziton të shkruajë për punën e zotit Sathas, autor i "Kronkës së Galaxhidhit", i cili që në vitin 1867 kish-të btouar një poemë të gjatë të Koronaios për nder të estradiotit Mercurios Bua, i një familje shqiptare....

Shënime
[1]Nga Rapsodi e një kënge shqiptare, përkthyer dhe bërë të njohur nga Gerolamo De Rada, botuar në Firenze më 1866. Canto XVII. Këtu po japim përkthimin në shqip të versionit të Dozonit, të botuar në frëngjisht në këtë libër mbi këngët bullgare.

[2]Atëherë të gjitha dritaret mbylleshin plotësisht, e po kështu edhe porta. Te ortodoksët e pasur të Janinës, vendosin në dhoma perëndë të zeza, madje dhe në divan vinin cobë të zeza. Fotografia e të vdekurit mbulohej me një shami të zeza. Dhe kështu, veujshat mbeteshin në këtë lloj varri vite të tëra, madje ato s'dilnin dhe për të shkuar në kishë.

[3]Zakoni i detyronte gratë të vajtonin (vaje) për të afërmit e tyre të vdekur. Ky zakon është më i fuqishëm te shqiptarët se te popujt e jerë të zonës danubiane. Ja pse vajzat i martojnë pranë familjeve të tyre.

[4] Sipas botimit të kësaj kënge në Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar. Në këtë përallë është e habitshme ruajtja e gjuhës epirote, çame, (e të folmes çame) siç e gjejmë edhe tek libri i Reinhold-it.

[5] Leonora - botuar nga Gottfried August Bürger (1747-1794), poet gjerman

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI


Artisti Maks Velo zgjedh kohë të caktuara për të përshfaqur idetë e tij. Kështu ka vepruar dhe këtë herë, në këtë fillimviti, kur me anë të ekspozitës së fundit në FAB, "Fshati primitiv ndriçohet nga meteorët" na ka sjellë perceptimin përmes imazhit të tij karakteristik primitiv në pasqyrimin e ideve dhe subjekteve të ndryshme, që ngacmojnë tërheqjen e tij artistike. Por shikuesi befasohet sepse edhe përballë subjekteve me tematikë të hershme kohore apo edhe të mëvonshme si ajo e Natës së Shën Bartolomeut dhe më pas dhe Byronë Politike e të tjerë, ka ngjyra dhe shumë dritë. Piktori e ka braktisur atë imazhin e dikurshëm disi teutonik me korniza dhe figurina të ngushta monokrome dhe tashmë i ka lënë vend hapësirave të pafundme sepse e sheh përgjithësisht këtë përmasë si frymë lirie, ku mund të ekzistojë përmasa e plotë e frymëzimit artistik.

Maksit i buron natyrshëm drita dhe ajo përcillet ngado tashmë në telajon e vet. Abstragimi, ngjyrat dhe fantazia miksohen për të sjellë botën primitive në kohën tonë, por edhe përcillet një lloj ndriçimi i spikatur që është bërë i natyrshëm në krijimtarinë e fundit të këtij autori punëtor. Si në një karusel gjigant, personazhet përzihen me subjektet dhe na japin një botë që lulëzon prej vitesh në shpirtin e piktorit tonë, pjesë e prezanimit të ideve artistike, gjeneruesit të debateve dhe jo vetëm. Ndosh-ta ta kuptosh më mirë, do të duhet të qëndrosh me të, të ndash shumë emocione dhe të kuptosh atë botë arti që lodron tek ky artist i mrekullueshëm që mbushet në formimin e vet nga disa gjini arti. Për të, ato figurat e hershme, ato që gjenden dhe në trashëgiminë tonë prehistorike dhe më vonë, janë baza e këtij arti të cilin e kemi deri në ditët tona. Po, po. Pa asnjë mëdyshe, kjo është një botë e madhe dhe e pa mëdyshtë. Nis që aty, ku paraardhësit tanë prehistorikë bënin planet e tyre duke përcjellë në mënyrë të kodifikuar idetë e hershme dhe abstragimet naive. Veçse, në rastin tonë, ky figuracion zbrit kur homosi i sotëm është shumë i përparuar dhe nuk struket më në shpella për të treguar botën e vet, por sjell atë akt, në një shpellë hipotetike, duke na i përcjellë subjektet tona me atë pamje të dikurshme. Dhe, ironia e Maks Velos është e hidhur. Zezona e kohës sonë e privon ertësirën tekta ai e vesh me drita të panumërta në një farë mënyrë për të qesëndisur edhe atë segment të gjatë, që është privuar.

Kuratori Mikel Tempo ka meritën se artin e Maksit, që prej vitesh ndjek të njëjtin fizionomi, e ka futur në një sens shumë interesant pasqyrimi dhe e ka kuruar me sukses.

Maksit i buron natyrshëm drita dhe ajo përcillet ngado tashmë në telajon e vet. Abstragimi, ngjyrat dhe fantazia miksohen për të sjellë botën primitive në kohën tonë, por edhe përcillet një lloj ndriçimi i spikatur, që është bërë i natyrshëm në krijimtarinë e fundit të këtij autori punëtor. Si në një karusel gjigant, personazhet përzihen me subjektet dhe na japin një botë që lulëzon prej vitesh në shpirtin e piktorit tonë, pjesë e përshfaqjes së ideve artistike, gjeneruesit të debateve dhe jo vetëm...

"Primitivët" me meteorët të MAKS VELOS



Ekspozita ka pasur hapësirë dhe shumë frymëmarrje por edhe mundësi në të cilën edhe shikuesi më i zakonshëm të kishte mundësinë e duhur të abstragimit që ai e fal me të gjithë talentin e vet, ngjyrat mbi metafora, ushqyer në vite prej interesave të gjëra të artistit.

Në një kënd Maks Velo i kushtoi shumë dhe nudove të tij duke na dhënë punë të mrekullueshme me shumë dritë, brenda natyrës primitive të formës së vet, duke



2019 Exhibition

na treguar se përfytyrimi i Maksit tashmë shkon shumë afër këtij konceptimi dhe krijimtaria e tij ka një fizionomi të përcaktuar qartë. Dhe, për këtë nuk ke nevojë fare edhe për modele (autori e ndjen me të drejtë si handikap mirëfilli), pasi autori ka shumë ndihmës atë që është më e jashtëzakonshme e që lidhet sinqerisht me mungesën e modeleve, të cilat kanë kërkesa specifike për tu paraqitur por edhe nuk e kanë shumë kulturën e paraqitjes nudo.

Për kuratorin Temo besohet se Maksit i është dashur shumë kohë që vendin e grafikës ku dominonte e zezja ta zëvendësonte me ngjyrat e ndritshme, por kjo nuk është asfare habi për atë që njeh këtë artist të rrallë dhe të paepur pas të bukurës. Dhe, teknika e tij është interesante sepse punon me shtresëzime, ku Temo veçon specifikën sesi artisti nga teknika e pastelit e forcon me akrilikun dhe shton me krenari edhe mënyrën e duhur sesi e përdor këtë mrekulli, ku tek e fundit përcakton dhe talentin e këtij artisti që ka bërë kaq shumë për kulturën tonë.

E
ESSE

Një mikes së këndshme të "Milosao" po i botojmë këtë esse, në shenjë respekti për dashurinë jo vetëm ndaj letërsisë, por edhe ndjeshmërisë së lartë të kujtesës historike

27 janar

NGA TATJANA ÇOKU*

Do të doja që fjalët për këtë shkrim të rridhnin pa resh tur. Sa keq që ndodhi e kundërta. Nuk ishte aspak e lehtë. Nuk ishte e lehtë të shkruaje për këtë ngjarje drithëruese, tmeruese e shkatërruese, sepse dhimbja të godet, lotti të mbyt, por edhe heshtja të vret, ndaj zgjedhja të mos rri gojë mbyllur e duar lidhur në këtë ditë kujtimi.

Rrëmbeva një fletë dhe një laps dhe thashë me vete e bindur: "Do të shkruaj". Hodha një vështrim mbi fletë e më pas u ndala, u shtanga, u bllokova. Pse? Sepse në atë letër dëborë të bardhë, m'u shfaqën pamjet e errëta, që çdo 27 janar përkujton. Njerëz që mbyten me gaz, njerëz që digjen në mënyrë të pamëshirshme, njerëz që hapin gropat në të cilat do të varrosen në një të ardhme të afërt. Dora dridhet e shoqërohet me një pikë loti që rrëshket butësisht në faqe e bie duke lënë një shenjë në letër. Ç'është kjo pika ime e lotit para



oqeanit të formuar nga lotët e mijëra nënave e baballarëve, motrave e vëllezërve? Ç'është kjo dridhja e dorës sime para mijëra dridhje zemrash, që kanë pasur hebrejtë nga frika e vdekjes mizore, e cila nga momenti në moment mund t'i kaplonte?

Pa e kuptuar, kisha kaluar më shumë se gjysmë ore duke ia

ngulur sytë asaj letre që ende ishte e bardhë. Më pas mendova: "Jo, nuk mund të lejoj që kujtimet e së shkuarës të vrasin të tashmen e të burgosin të ardhmen. S'mund të lejoj të shkuarën të mohojë faktin, se hebrejtë janë shembull për t'u ndjekur dhe jo "racë e papastër"; të mohojë dorën e zgjatuar nga vendet e ndryshme ndaj

hebrejve, dorë e cila bëri që shpresa të lulëzojë shpirtin dhe të ndriçojë mendjet e hebrejve".

Hebrejntë duhet të jenë frymëzimi ynë. Askush më shumë se ata e kupton se çdo të thotë "humbje", "trishtim", "ankth" e "makth". Hebrejntë nuk u bënë robër të këtyre vuajtjeve dhe të pesimizmit prangosës. Ata u ngritën, filluan të ecnin edhe pse gjunjtë më s'i mbanin. Hebrejntë ishin të dërrmuar e po zvarriteshin, por ata kishin këmbë të forta dhe filluan që të rriteshin. Ata i dhanë kuptim fjalës "forcë". Hebrejntë na bëritën e na treguan se gjithçka është e mundur. Ata kishin plotësisht të drejtë. Shikoni ç'kanë arritur sot: paqen, bashkëjetesën, lumturinë e çdo gjë të mirë që ata dëshironin dhe e dini pse? Sepse arritet, sukseset e fitoret e mëdha i korrin ata që punojnë dhe këmbëngulin shumë.

*Nxënëse e klasës së X.A, shkolla "Kristaq Capo", Berat

P

POEZIA

Autori ngre një metaforë lirike për të shpalosur mendimin e tij në filozofinë e jetës që e rrethon...

Kur gjethet gjithë delikatesë bien

"Etyd"

NGA SOKRAT PASKALI

a)
 vjeshtë mëngjes e martë
 mbrëmë gjithë natën ka rënë shi
 tani nuk po bie më vranët
 meteorologët kanë thënë shi do bjerë edhe
 sot
 si në skenën e një teatri eci në trotuar
 rrëkeja rrjedh turbull
 në enigmatikun ritual
 Pesoa më pëshpërit në vesh
 qyteti është natyrë Sokrat
 të zbehtë e përfytyroj të mbledhur kruspull
 ai ka shumë emra unë vetëm një
 si destini
 rrëkeja i rrjedh në krahun tim ujrat symby-
 llur
 pemët bëjnë spektakël
 i rrezojnë gjethet gjithë delikatesë
 më pëlqen edhe mua mendimet ti rendis si
 ato
 me finesë
 vetja pemë me ngjan
 gjethet që sapo ranë përpiqem mos ti shkel
 pllakat në trotuar s'ka shumë që janë sh-
 truar
 kalimtarë në qafë mbajnë tabela shkruar
 dhe njeri-tjetrin tregojnë me gisht
 i i hi hi hi
 lyster në të ndezur fasadat e vjetra
 si fytyra të zbehta lehonash pa lindur
 lart ngrihen kulla të reja si të vjetrat por pa
 frëngji
 brenda pimë kafe këmbëkryq
 shkruar si me gisht aty-këtu fjalë anglisht
 o sot a i ri është ky qytet o zot
 sikur nga dheu mbiu sot
 kur gjethet se si bien shoh
 më mblidhet një gulç në gjoks
 është poezi
 ja jam atje ku s'kisha qenë më parë
 asnjëherë
 shoh e klith
 i i i
 i tëri vjeshtë kokë e këmbë jashtë e brenda
 gjethet gjysmë të gjelbra gjysmë të verdha
 si mendimet e mia të rejtat të vjetrat
 ç'e zonja paska qenë regjisorja era

b)
 diçka po ndodh e ndjej po nuk e shoh
 diçka që erën me qiellin lidh
 unë i çuditur si aguridh
 qielli ka vetëm re
 ajthi im si çdo biomë gjallit me diellin jo
 po diell s'ka
 ah oh eh
 shpirti shakull përdhe
 fshaj në melaqe
 a mos është vallë elf
 figurinë që muzgu po dhe nata e krijon flu-
 turak
 jo nuk është as muzg as natë
 mëngjes është vjeshtë e martë
 gjithë natën ka rënë shi mbrëmë
 meteorologët prapë do bjerë kanë thënë
 vrunduj-vrunduj qetë-qetë paqesisht
 fryn erë e lehtë
 pemët shkundin gjethet në trotuar
 në ritual gjithë elegancë
 në ajër ç'finesë
 gjysmë të verdha gjysmë jeshile si gjethet
 mbledh mendimet rrëke turbullire
 në cast ndje një si ankh
 dua të përulë të lutem gjithë dënësë të qaj
 ngre kokën lart
 aty në gri
 pikërisht aty
 midis reve
 në një anë
 oh - një të çarë



një e çarë e paparë
 i lutem asaj
 me njerën dorë në zemër
 me tjetrën në skaj
 s'jam luledielli kur kokën kthen
 s'jam si para të elfit figurinë që pyet rutinë
 delfi tha të vërtetën apo gënjen
 në qiell oh një e çarë
 më klith nga brenda një zë si i marrë
 një e çarë si far
 o perëndi
 më përshëndet një skeptër
 vetë ajo që zgjedh e përzgjedh
 të gjallë e të vdekur me tekën e kreshpur
 i verbër isha i gjori s'ish era regjizori
 me pemët me gjethet me mendimet me uj
 që rrjedh
 me shiun që binte e s'bie
 isha aktor
 perëndeshë e dashur që qiellin çan
 dhe jermi e poezisë në shpirt ma kullon
 të lutem më ndihmo
 ti e di se ç'dua
 veç ta kam thënë në vesh
 çu çu çu
 qiellin mos ma ndërro
 sytë nga drita mos mi çvish
 më ndihmo verbërisht
 mbushem thellë me frymë
 jam i tëri vjeshtë kokë e këmbë
 diçka po më ndodh

në pejsa abise ku më pas s'ka asgjë më
 skeptri vezullon mua sytë mi lag
 sytë e mi janë sytë e tu në muzg e në ag
 tani përherë e në jetë të jetëve
 këtej e matanë
 dhe oh blu me doli
 ç'ofshamë

c)
 e martë mëngjes vjeshtë
 mbrëmë gjithë natën ka rënë shi
 tani nuk po bie vranët
 meteorologët kanë thënë shi do jetë edhe
 sot
 eci në trotuar si në skenën e një teatri
 rrëkeja rrjedh turbull
 qyteti është natyrë pesoa kruspull në vesh
 më pëshpërit
 ai ka shumë emra unë vetëm një si destini
 pemët bëjnë spektakël era gjethet i rrezojnë
 gjysmë të gjelbra gjysmë të verdha
 si mendimet e mia të rejtat të vjetrat
 që elegancën e gjetheve nuk e kanë
 përpiqem mos ti shkel ato që sapo ranë
 shoh në qiell një e çarë dhe ndje një çast
 një ankh
 nevojë kam të përulë të lutem të qaj
 të mbushem thellë me frymë me njerën dorë
 në zemër
 me tjetrën në skaj

jo për ajthin rrezen e diellit
 qorrit të zjarrtë që veten djeg po dot se shoh
 as për figurinë fluturcake të elfit
 po për jermi e poetit
 që e çara në qiell e rrjedh
 në ujra të tjerë
 feks ky far në vetëtimat e skeptrit pa ylber
 ankthin ndjej në fyt më zë në shpinë më rri
 përulë lutem qaj si asnjeri
 me njerën dorë në zemër
 me tjetrën në skaj të kjo hyjni
 që dritë merr nga sytë e mi
 mi err mi pulit mi gërryen
 mi skuq mi ha
 e mi sjell përsëri
 e mi merr e mi sjell
 përsëri e përsëri e përsëri

c)
 e martë mëngjes vjeshtë
 mbrëmë gjithë natën ka rënë shi
 tani nuk po bie vranët
 meteorologët kanë thënë shi do bjerë edhe
 sot
 plot
 eci në trotuar si në skenën e një teatri
 rrëkeja rrjedh turbull
 fernando pesoa në vesh më flet
 qyteti është natyrë
 ai me shumë emra unë vetëm me një
 si destini
 pemët bëjnë me gjethet spektakël
 i rrezojnë gjithë delikatesë
 edhe mua më pëlqen mendimet ti rendis
 me finesë
 vetja më duket pemë
 gjethet që sapo ranë përpiqem mos ti shkel
 pllakat në trotuar s'ka shumë që janë sh-
 truar
 si kalimtarë ardhur nga larg
 gjysmë të verdha gjysmë të gjelbra gjethet
 si mendimet e mia të vjetrat të rejtat
 jam i tëri vjeshtë kokë e këmbë jashtë e brenda
 nevojë kam të përulë të lutem të qaj me
 dënësë

e të mbushem thellë me frymë
 me njerën dorë në zemër me tjetrën në skaj
 jo për ajthin
 rrezen e diellit qorrit të zjarrtë
 që veten djeg e dot se shoh
 as për figurinë fluturcake të elfit
 po për jermi e poetit
 që e çara në qiell e rrjedh në ujra të tjerë
 dhe vetëtimat e skeptrit pa ylber
 feksjon far
 si për herë të parë

d)
 në kryqëzim arrij ndaloj
 me vargje si me gurë në gojë
 semafori bardhë e zi
 pranë e çuditur statuja e një presidenti
 e një lypësi ah sa do doja të ishte një shta-
 tore
 lart dorën ngritur drejt qiellit shtrirë
 me tjetrën të mbante pendën e një skrivi
 për të skalitur fjalë si magji
 o njeri
 empati empati empati
 o njeri
 sa e rrallë dhe e mbrohtë kjo fjalë
 të mbërthen e gjallë të mban
 si fener diogjeni sytë mi pulit
 e përballë veten shoh

T

TREGIM

Ky është një tregim i hershëm, ku realizmi i theksuar përcjell dhe frymën lirike shqetësuese të problemeve, me të cilën hasej zhvillimi urban kombëtar në mes të dy luftërave të Mëdha...

Kur bie shi në Shkodër

NGA VIKTOR KOLIQI*

Kola, shoku i im i fmijnis, banon te në Serreq në rrugën Krraqej. Banesa e tij ishte e vorfen. Nji shkallë druni, drejt nga oborri të shpiente n'odë të zjarmit; nga kjo, tue kalue nëpër një derë t'ultë u arrinte në dhomën e Kolës. Baba i këtij ente, aty në odë të zjarmit, në një dshyek të shtruem mbi një rrgostë të grisun. Dhoma e Kolës ishte dhomë fjetjeje, për të, e njikohësisht edhe dhomë studimi. Kishe hy shum herë në shtëpin e këtij shoku të dashtun e të pahirrëshëm të klasës. Ndër vjetët e shkollës kur ndiqëshim gymnazin, aty, në dhomën e Kolës kishim pregatitë detyrë shkollore. Kur arrijtëm në të dytën lycë, vendosëm të takohemi çdo mbramje ke ai për të përqendruar e thellue vemendjen t'onë në studime. Ishin dy vjetët e fundit të shkollës së mesme, e, lypej prandej, një vullnet më i fortë në pregatitje. Në të vërtetë, kjo methudhë e bashkueme u tregue frytdhanësë sepse na ngeli më mirë në mend mbrendësia e teksteve klasikë dhe na u duk më i lehtë ushtrimi dhe shpërthimi i problemeve algjebrikë. Në një mbramje vjeshte të vjetit 193... gjindësia në dhomë të Kolës. Ishim tue përkëthye disa vargje t' Eneides. Binte shi mbi Shkodër. N'atë mbramje, m'u duk si t'a shifshem për të parën herë dhomen e Kolës. Nuk dij si t'a shpjegoj arsye e këtij zbulimi të papritun. Ndoshita pse herët tjera nuk i kishe dhanë randësi disa imtimeve qi i kishin shpëtue shikimit t'im, n'atë natë pash për të parën herë vertetësin e trishtueshme të një vorfënjë së pa caqe. Tri perde të shveshuna, picak. Vetëm dera e ultë në njanën dhe një dritore e vogël në tjetrën perde thejshin vazhdueshmenin e thatë të mureve. Në perden e katër, në dy drasra të mbajutuna në mur me gozhda, rendoheshin librat e Kolës, kund njiqind vëllime. Nën kta libra, një tryezë e vjetër mbi të cilën bënte dritë një kandil vojturi. Aty, në të djathtën, jo larg tryezet, kalendari. I vjerrun në mur, i hapun në etën e nandorit, kalendari i Pader Frakjonit shenonte: «vetima e bubullima; shi me rrshikë». Binte shi në Shkodër. Librat e Kolës, qi randojshin mbi ato drasra të pagëdhenua, kandili vojturi mbi tryezë të vjetrueme, muret e shveshuna e shiu qi tash një javë binte mbi qytet, i zbuluen shpirtit t'im n'atë mbramje vjeshte, një anë të thellë të mbrendësme të jetës shkodrane. Nji paradoks i

trishtueshem përmbilidhej mbrenda atyne katër mureve. Në njanë anë, vullneti i njeriut për përmirsim të gjendjes; në tjetren anë, vorfnija. Kola e dinte se pasunija e njeriut nuk është vetem landore. Për këtë arsye i ishte mvëshë studimeve me vullnet e cenë. Dishiri i tij me njoftë mbrendësin e teksteve t'auktorve të mëdhej të botës e bani të tonte, endë në moshtë të rë, një pregatitje të thellë. Këtë, e dishmojshin jo aqë tekstet shkollore sa vëllimet tjerë të shkrimtarve më të njoftun të mendimit botuier qi Kola kishte blë me sakrice të mëdhaja. Vullneti i Kolës për përmirsim të gjendjes, e kishte vëndue aty, mbi ato dy drasra të pagëdhenua të asaj dhome së vorfen, pasunin e paçmueshme qi ata vëllime përmbajshin. N'anë tjetër vorfnija. Gjendja e vorfen e Kolës u shifte. Vorfnija! Përbindësh i shkyem e i coptuem. Përbindësh me bira. Vullneti i Kolës ishte mundue t'a arnojë. Koll. Birat e shpirtit të Kolës u shifshin. Në shprehjet e tija dukej qartas se ai nuk donte qi ky kusht i pa fat (e nuk ishte vetem vorfëni landore), të ndiqte



më tutje brezninat e ardhëshme shqiptare. Mendimi i tij i ngulun ishte se, me vullnet, me punë e me studim mund t'u luftonte vorfnija dhe pasojat e saja të mjerueshme. « Forsitam et Priami quae fuerunt fata requiera ». « Të kishte rë shi, sikur bje sot në Shkodër; atë natë qi u ndez akë Troja, Eneu s' do t'i tregonte Didonës historinë qi të gjithë njom » - lloj të asë Kola. Nuk u çuditëshem për kta shprehje të tija. E njëjshë mirë dhe e dijshe se pikënisjet e mendimeve të Kolës kishin një largësi të thell. Kto mendime vijshin, mandej, tue u shtjellue në nji arsyetim të rrasët plot themele argumentimi. Megjithëse mund duket qesharak llimi i bisedës së tij, unë e lejshe të itte e e ndigjojshe me andje. « Due të tallem - vazhdoi - s'hynë në perde lufta e Trojës. Deshta të tham se shpesh herë fati i njeriut është i caktuem prej disa rrethanave qi janë më pak përcaktuese se vetë mudi i njeriut për ndryshim e për përmirsim të gjendjes në të cilen gjinden. Unë marr si shembull babën t'em. Em at është atjë, n'odë të zjarmit, tue fjetë. Nuk është ende ora tetë e mbramjes, e em at ka rë në letarg. Mos u qesh. Ti e din punën qi bën em at. Kur nuk bjen shi, shkon në zall të Kirrit me qerre për të bajtë gurë e ranë. Kur do të pushojë ky shi? Për dy muej rresht nuk ka më zall Kirrit. Gurët e rana janë mbulue nga uji, e baba i em është i shtërnguem të ngujohet në shtëpi, pa punë. Ky letarg i babës m'a dermon shpirtin. Pse? As unë s'e dij. Dij vetëm se qe bash baba i em qi më nguli në mend dishirin për studime. Pa më thanë gjë, pa më nxitë, kuptova se qellimi i tij ishte qi unë, në jetë, mos t'ishe si ai. Në duert e tija të plasuna nga puna, unë pash deshtimin e krejt një gjendjeje shoqnore qi njerzit, si baba i em, e kuptuen, por të cilës qenë të shtërnguem t'i shtrohen. Çka do të bajmë na për t'a ndihmue ket njeri, qi si baba i em ka mbi shpatulla një trashigim të lashtë e të randë vorfnije? ». Binte shi mbi Shkodër. Kola u çue, shkoi n'odë të zjarmit e u këtheje me një kovë qi vendoi aty; për tokë, në një skaj, në një cirkë uji qe pikonte nga tavani. Lëvizjet e tija të natyrshme m'u duken si ryt i lashtë. Nji ryt i natyrshem e i lashtë në shumicën e dhomave shkodrane. Kur bje shi në Shkodër, shiu hynë edhe mbrenda shtëpiveja. Këthei në tryezë e prap foli: « E shef? Duhet të pohoj se në këtë rasë kam lind me fat. Këtu, pranë librave nuk pikon shiu. Na shqiptarët jemi mikpritsa. Si do t'ishte po

t'i u lagëtë barku Sanço Panços ase hunda Ciranos -it? Do të ngelëshin të fyem babajt e këtyne herojeve, thue ti. Ke të drejtë. E kemi detyrë, prandej, të kujdesohemi për t'i rrujet sa më mirë. Me kta heroje na lidhë një dashuni e thellë shpirtore. Nuk duhet t'i hynë në shpirtë edhe atyne kjo lagëshinë e ky ujë. Duhet të shpëtjë nga shtërngata, nemose, mendimi i tyne. Ky për mue, është një dishirë e njikohësisht edhe një shpresë. Por, si është vrë

qielli, edhe kjo shpresë errësohet. Sot në mengjes, tue shkue në shkollë, shikova andej kah gryka e Bunës. Gryka e Bunës është barometri i Shkodrës. Në mes të Kalas e Taraboshit, tymi i zi i rëve, si të dilte nga një fabrikë o avullore e padukëshme, naltohej mbi qytet. E, kta rë ecshin e ecshin të pa ndalueshme nga prendimi në lindje tue mbyllë horizontet ». I ndigjojshe fjalët e Kolës në heshtim. Cirka e ujit mbi kovë ishte bërë. Shikojshe në shpinën e librave të renduem mbi ato drasra të pagëdhenua, titujt e auctorët. Homeri, Dante, Shakespear, Goethe, Molière, Cervantes, Ronstand, Proust etj. etj. Mendojshë me vedit: çka duen aty, n'atë dhomë të vorfën kta njerëz të mëdha? Pse kishin xanë vendbanimin e tyne kta vigaj të mendimit, aty, në lagjen Serreq, në rrugën Krraqej? A e dijschin ata, se për bri, n'odë të zjarmit, shtruen mbi një rrgostë të grisun, ente i ati i Kolës, anal-fabet? Jashtë binte shi. Mbrendë, pikonte uji nga tavani. « Nuk të kam tregue prap foli Kola - çka më ngjau dje. Gjindësia në dyqanin e mikut t'onë prestar, Lok Rikja. Mbas sa çasash po hynë mbrendë sekretari i Prefekturës. Qellimi i kësaj vizite qe i qartë. Kishte sjellë me vedit një stofë inglize për të prë një parë rrobe, e i tha prestatit se i u dojschin të gatëshme mbrenda pak ditëve. Nuk i dhahë randësi kësaj punë, pse, sikur e din, n'at dyqan hynë njerëz të shumë të ndryshem. Por çudija o më mirë të tham ngjarja qi due të tregoj qe kjo: si e përshndeta më shikoi me kureshtë, e tue më pa me turër të librave në dorë, m'u suell... « kishe me dashtë të dij së okë peshojnë të gjithë ata libra ». Unë, tue kuptue se ndërhyjja e tij kishte një dritë t'ashper talljeje, i pergjegja « pësha e këtyne vëllimeve nuk është e madhe, peshon shum, përkundrazi, mendimi qi kta libra përmbajnë ». U afrue edhe pak, për të vretjtë më mirë e... « shikò,

shikò - tha - paske edhe Ciceronin. Sa për vedit s'kuptoj ç'na duhet në shqiptarë teksti i nji auctorit latin. Nuk shof ç'farë frytit mund të nxjerrim tue studue tekste ksi lloji ». « Ciceroni - thashë prap unë - ka qenë një ndër shkrimtar më të mëdhaj qi ka pasë Roma e vjetër. Mënyra e shkrimit të tij merret si shembull shtjellimi e arsyetimi, e tekstet e tija mshohen në të gjitha shkollat e botës ». « E dij e dij - më pergjegji - nuk është nevoja të m'a thuesh ti qi ka qenë shkrimtar i madh. Por shkrimtarët nuk shprehin tjetër veqë fantazina. Në Shqipni, sot kemi nevojë më teper për teknikë se sa për shkrimtar ». « E shef si qindron puna o i dashtun - vazhdoi Kola tue me shikue me vretjtje, si të dishronte me njoftë nga unë një lloj mendimi mbi këtë bisedë qi pat me sekretarin e Prefekturës - e shef? Mundë i kotë me bajtë librat nën krahe. Tallen me ty. Edhe unë e kuptoj e e gjykoj t'arsyeshme qi vendi i ynë ka nevojë për teknikë, por nuk është e thanun qi ata qi merren me degë tjera të ditunis të shvlefësohen. Po u pregatit secilli me cenë e me ndërgjegje, vendi i ynë mund të nxjerr fryt nga të gjithë. Em at anal-fabet, ka ndieshmeni më shum, në pikpamje të mendimit njerzuer, se sa sekretari i Prefekturës, Em at ka një ndërgjegje, pse e njëj gjenden e mjerë në cilën gjindet, dhe shef se edhe rreth tij kjo gjendje nuk është aspak më e lume. Vullneti i ynë më shtini em at për studime, nuk duhet t'a marrim vetem si shkak egoistik për të përmirsue edhe jetesen e tij; është ndërgjegje e thellë, qi edhe një njeri i pa shkollë mundet t'a ketë në vetvedit. Sekretari i Prefekturës nuk është anal-fabet. Është gjymësmak. Ktu qindron dami dhe keqkuptimi. Njerz sikur ai i kanë tue pozitat e tyne shoqnore prej disa rrethanave të shtërngta. Njerz sikur ai, i kanë ndigjue vetem emnin Ciceronit, pa pasë lexue asnjë rresht të këtij shkrimtari. Por, nga naltësija e rendit zyrtar kallp të tyne, predikojnë, si t'ishin sipërmarrës të rindertimit shoqner të kombit. Mendimet e kytyne njerzvet janë si rëte e zeza. Mbyllin horizontet. Nuk duen të lanë me kundruem më larg. Duen qi edhe të tjerët të zhyten në botën e tyne t'errët, gati si të kishin fryt nga letargu i të tjeruet ». Zani i ultë i Kolës, me vezullime andrre, n'atë natë vjeshte plot shi. Monolog i një shpirtit me bira. Shikonte librat e rreshtuem mbi ato dy drasra të pagëdhenua. Drita e kandilit vojturi u dridhëte mbi ta. Flitë: « Shkrimtar?... fantazi?... Pse arrijti deri ke na mendimi i tyne? Kush i tha të vijnë dera

këtu, në këtë dhomë?... udhët e largta të botës ju kanë sjellë në rrugen Krraqej. A e dijshe se muret e kësaj shtëpi janë të lodhuna? Njerzit ju shvlefëtojnë, ju përbuzin?... Shkrimtar... Fantazi... Në një natë si kjo, ju duhet të merrni guximin e të utroni jashtë, në stuhi. Larg... larg... fantazma të lagun në shtërgatë e t'asgjastuem nga vorfnija mendore e njerzvet... Pse? pse jem të dënuem me jetue në një mendësi kaq të ligë? ». Shfrimi shpirtuer i Kolës: monolog i një nate vjeshte të vjetit 193... Kur bje shi në Shkodër; naten, terri shpartallohet nga drita të paprituna vetimash. Bubullimat trandin themelet e shtëpiveja tue shungullue të tmerrëshem n'afersi, e tue u sosë, më andej, në një gjamë të trishtueshme e të largët. Uji shprazet nga qielli. Liqeni, Buna, Drini e Kiri rrethojnë qytetin; frw hen, dalin nga ama e mbulojnë ara e kopshtije, rrrugë e oborre. Muret e shtëpajat janë ishuj guri: shkambijë të lashtë e të lodhun qi i qindronë çdo katakizim. Shkodra në shi, Kola, librat, dhoma e vorfen, mendimet, baba i Kolës në letarg! Nji arkë e Noehit qi lundroi gjithëherë e lundron edhe sot në shtërngatë, në këtë mbytyje të botës n'ujë, e nuk gjenë endë, shkambin e Araratit shpëtues.

*Marrë nga Shkodradaily

Opinionimi / i Ditës

Pse më fut dorën në xhep për 15 vjet, qeveri?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... ose 364 milionë euro), ngelen 164 miliardë lekë të reja, ose 1.32 miliardë euro. Ose një e dhjeta e Produktit të Brendshëm Bruto të vendit! Kaq janë detyrimet e Buxhetit të Shtetit tim për 15 koncesionet e tjera PPP (duke filluar nga shërbimi absurd-tërisht i paqenë i markimit të karburanteve 1 vitit 2012, tek ai tejet i kushtueshëm i skanimit të automjeteve në dogana, duke vijuar me shërbimin e kontrollit bazë-check up e deri te tri akset e tjera të reja rugore Milot-Balldren, Kardhiq-Delvinë dhe Orikum-Himarë). Shumica, të shtrira në kohë pagimi nga Buxheti për 10-15 vjet. Të gjitha janë kontrata të nënshkruara, një pjesë e mirë në zbatim. Së bashku me kontratat që do të hyjnë në zbatim për këtë vit, shumica e detyrimit buxhetor të shtrirë ndër vite i kap mbi 20 për qind ose një të pestën e 1.6 triliardë lekëve të reja të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit. Kjo shumë nuk është përfshirë në llogaritë e borxhit publik, pasi qeveria nëpërmjet buxheteve vjetore përllëgarit vetëm pagesat vjetore që duhet të bëjë, të cilat nuk duhet të jenë më shumë se 5 për qind e të ardhurave tatimore të atij viti. Ky kufi njihet në të gjithë botën, për të mbajtur qeveritë të përgjegjshme dhe për të bërë të mundur financimin e investimeve publike për vitet që vijnë, pa u kushëzuar dhe pakësuar nga problemet e pagesave me Partneritet Publik-Privat, që lidhin qeveritë kohë pas kohe. Po të përfshihet shumica e detyrimeve koncesionare PPP në borxh, borxhi ynë publik fluturonte në 82 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto. Megjithatë, po e lëmë qeverinë të mburret me uljen e borxhit tonë publik (edhe pse realisht, me detyrimet e prapambetura dhe rimbursimin e vonuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar po ndodh e kundërta). Mirëpo si qytetarë nuk mund ta fallim, kur me planet e saj të investimeve PPP do të na rëndojë taksat për 15 vitet e ardhshme, ose do të pakësojë shumë fort investimet publike (nuk ka rrugë të tjera). Po pse? Sepse 5 përqindëshi i të ardhurave nga taksat që duhet të mos kalojnë pagesat për koncesionet PPP po vjen shumë shpejt. Vetë qeveria po e afron, duke thënë se me sponstimin e aksit rrugor Thumanë-Kashar i ka dhënë hapësirë vetes të paguajë për studentët, sidomos për ndërtimin e kampusit të ri universitar. Shumë mirë që po fut para tek Pakti për Universitetin, por kur të gjitha kontratat koncesionare PPP të hyjnë në vepër, pagesa vjetore do të rritet në mënyrë të pashmangshme, duke e tejkaluar kufirin 5 për qind edhe në më pak se dy vjet! Çdo të thotë



kjo për mua si qytetar? Që për shembull, për vitin 2021, për të përballuar detyrimet PPP, qeveria ose duhet të më rrisë taksat që unë paguaj, ose të më pakësojë investimet publike që po bën deri tani. Po ç'kusur kam unë të përballoj këtë aventurë të sotme qeveritare?! Nëse paguaj taksat rregullisht, pse duhet të më shtohen ato, apo të marr më pak shërbime shtetërore nga investime publike të mpakura? Unë në Milot dhe Balldren shkoj edhe tani me rrugët që janë sot. Të njëjtën gjë bëj dhe shkoj sot edhe në Orikum, Himarë, Delvinë apo Kardhiq. Pse, për të pasur rrugë më të mira për të shkuar në

këto vende duhet të paguaj unë-qytetari në vitin 2021 e tutje taksa më shumë për 10 apo 15 vjet të mira? Apo shteti duhet të më japë investime më pak? Që të majmen oligarkët që i kanë fituar këto tendera? Asnjë tender për koncesionet PPP të mbyllura këto vitet e fundit nuk ka njohur qoftë edhe një pjesëmarrës përfaqësues të vetëm firme të njohur ndërtimi ndërkombëtare, apo mjekësore apo farmaceutike në shërbimet koncesionare PPP në mjekësinë tonë publike. Kjo çfarë është? Kaq pa interes janë këto tendera me vlera dhjetëra e qindra milionë euro për kompanitë e huaja, qoftë edhe nga

rajoni, që të marrin pjesë e të përvetësojnë garën tek ne? Kjo përbën një turp të madh. Asnjë kompani e huaj serioze nuk ka pranuar të marrë pjesë në këto tendera-paçavure, pse kësaj qeverie deri përpara pak javësh i lexohej e shkruar në ballë emërtesa "tendera publikë për oligarkët e mi"! Dhe asnjë kompani e huaj ndërtimi apo mjekësore nuk kishte kohën dhe paratë pa kufi për të marrë pjesë në një garë të trukurar ende pa filluar. Situata po ndryshon disi me kthimin mbrapsht të koncesionit PPP Thumanë-Vorë-Kashar. Por është një dallëndyshe e ndrojtur, që nuk sjell pranverën. Rrugët e reja (me përjashtim ndoshta vetëm të asaj të Arbrit) mund të presin edhe pesë vite të tjera apo edhe një dhjetëvjeçar. Përparësitë e ekonomisë sonë janë diku tjetër, në paratë për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit. Dhe ndërkohë, asgjë e tillë nuk ndodh me eksperimentet aventura të rrezikshme PPP. Si qytetar po ta them qeveri: Më ke hyrë krejtësisht pa të drejtë në xhepin tim për 10-15 vitet e ardhshme. Duhet të dalësh prej andej. Gjeje ti, qeveria ime, një mënyrë si të dalësh. Unë nuk të dua më në xhepin tim edhe për 15 vjet nëpërmjet PPP-ve!

Asnjë kompani e huaj serioze nuk ka pranuar të marrë pjesë në këto tendera-paçavure, pse kësaj qeverie deri përpara pak javësh i lexohej e shkruar në ballë emërtesa "tendera publikë për oligarkët e mi"! Dhe asnjë kompani e huaj ndërtimi apo mjekësore nuk kishte kohën dhe paratë pa kufi për të marrë pjesë në një garë të trukurar ende pa filluar.

HOROSKOPI

DASHI

Ritmi është çelësi i suksesit në çdo aspekt të jetës suaj sot. Duhet të bëni më të mirën tuaj për të përthurur ritmin tuaj me njerëzit që ju rrethojnë. Sot mund të jetë sfiduese, por keni aftësitë e nevojshme për të bërë më të mirën.

DEMI

Jeni duke fituar një profil më të lartë dhe kjo është një ditë e mrekulueshme për vetë-promovimin. Njerëzit janë të gatshëm të dëgjojnë të përdorin fuqinë e tyre dhe paratë të tyre për t'ju ndihmuar.

BINJAKET

Sot mund të ketë pak tension përreth jush, por mos harroni se ndjenjat tuaja kanë rëndësi. Sot është e rëndësishme jo vetëm që të kemi komunikim të vazhdueshëm, por edhe të kemi komunikim të singertë.

GAFORJA

Besimi i patundur do t'ju japë energji sot. Njerëzit që duhet të dëgjojnë tani janë ata që e dinë saktësisht se çfarë po thonë. Nëse me financat nuk i keni pasur punët mirë, sot është koha për ndryshime.

LUANI

Dynerëz në jetën tuaj mund të duken sikur po shkojnë mirë, por nën sipërfaqe ka shumë presion mes të dyve. Përfshirja në këtë mosmarrëveshje mund të jetë shumë e rrezikshme. Do të shihni se ka dy anë shumë të ndryshme në këtë histori.

VIRGJERESHA

Ju do të keni një mundësi për të frymëzuar njerëzit e tjerë sot. Do të jetë e lehtë për të motivuar udhëheqësit dhe për të takuar njerëz të tjerë, që duan të bëjnë një ndryshim. Në dashuri mund të ketë zhvillime pozitive.

PESHORJA

A keni frikë se ajo që doni të thoni nuk do të pritë mirë? Mos hiqni dorë nga opinionit tuaj, edhe sikur të konsiderohet i papranueshëm. Në një moment do të kuptoni se nuk do të mungojë vlerësimi.

AKREPI

Marrëdhëniet tuaja më të ngushta po kalojnë një ndryshim tani dhe marrëdhëniet të reja po nisin të krijohen. Njerëzit po tërhiqen pas jush, njerëz që kurrë nuk do të kishit imagjinuar se të ishin të interesuar për ju.

SHIGJETARI

Edhe nëse nuk i kujtoni plotësisht të gjithë, ëndrrat konfuzë që keni pasur mund t'ju bëjnë të ndihni keq. Mos u mundoni të luftoni ndjenjat tuaja. Sa u përket financave, tregoni guxim me një mundësi investimi.

BRICJAPI

Të qenit vetvetja nuk do të jetë e lehtë sot, sepse shumë çështje do të lëvizin rreth disa njerëzve dhe vendëve që kanë shumë interes për ju. Tek disa persona mund të keni një ndikim më të madh se zakonisht.

UJORI

Konfliktet e një miku do t'ju detyrojnë të mendoni rreth ndjenjave tuaja të thella mbi atë që po ndodh në jetën tuaj. Lajm i mirë është, se ju do të merrni konfirmimin që jeni në vendin e duhur dhe në rrugën e duhur për të gjetur qëllimin tuaj.

PESHQIT

Ekziston një ndryshim midis kryengritjes dhe ndërmarrjes së një iniciative. Ju e dini atë që po bëni dhe njerëzit janë gati të ndjekin shembullin tuaj. Tregojuni atyre rrugën që duhet të ndiqet dhe do t'i ndihmoni që të shmangin harxhimin e kohës.


Opinion i Ditës

Identiteti "made in Albania"

Nga BLENDI FEVZIU

(vijon nga faqja 1)

... elektronike të një mikut tim të vjetër. Një ish-studenti të shkëlqyer të matematikës, me të cilin më shumë sesa studimet, na bashkonte para viteve '90 pasioni i stadiumit dhe ajo drithërime e çdo të diele pasdite, kur "Dinamo" dilte në fushë dhe ne e ndiqnim me një ndjesi tashmë të harruar. Pastaj pasditët e bordurës, kur më shumë sesa profesorët, personazhet e bisedave tona të tensionuara qenë futbollistët dhe kur debatet e thjeshta shndërroheshin në disa betejë fjalësh, që shumë shpesh më duken si pararendëset e Parlamentit të sotëm. I kënaqur nga kjo rigjetje pas shumë vitesh, i nisa një mesazh të shkurtër, duke besuar se ndryshimet dhe koha e largët duhet ta kishin zbehur disi atë kujtim të mrekullueshëm të një jete tjetër. Në të vërtetë nuk ishte ashtu dhe mik u m'u përgjigj shumë shpejt, duke kujtuar me një saktësi të frikshme shumë detaje dhe situata të harruara, duke nënvizuar absurditetin e kohës, por pa e fshehur edhe një lloj nostalgjie. Nostalgjia normale që ka çdo njeri për fëmijërinë apo rininë që nuk kthehet më. Kudo dhe sido që të ketë qenë ajo. Nuk e di pse pas mesazheve të para, ai më sqaroi diçka për familjen që kishte në Boston, për dy fëmijët që tashmë po rriteshin dhe shqetësimin se pavarësisht shqipes së gjumtuar që flisnin të dy, ndiheshin pak ose aspak shqiptarë. Mesazhi tij, që kishte brenda në të vërtetë shumë dhimbje, më kujtoi një tjetër debat të gjërë në internet për po të njëjtën temë: sa e pranishme do të ishte Shqipëria në fëmijët e emigrantëve të vendosur tashmë prej vitesh jashtë dhe sa problem krijonte kjo të prindërit e tyre? Më shumë sesa një pyetje apo dëshirë e thjeshtë, ajo shkante shumë më tej. Sa të lidhur do të ishin këta fëmijë me prindërit e tyre, të formuar dhe të edukuar në një mënyrë krejt tjetër, peng apo robër të parimeve dhe filozofive të ndryshme? Pra, sa mund të kuptoheshin në një botë të re, kur prindërit dhe fëmijët do të hynin me botëkuptime thajse diame tralisht të kundërta. Çështje identitetesh mendova, ndërsa mik u m'u vijonte të më kujtonet plot skena të mrekullueshme të viteve të rinisë, skena dhe detaje që asnjë nga fëmijë e tij nuk mund t'i kuptonte. Po cilat janë ato rrethana që përcaktojnë identitetin e një personi dhe sa të trashëgueshme janë në familje apo të fëmijët? Dhe sa mund të ndihet njeriu i plotësuar nëse një rrethanë apo një tjetër e ka privuar nga shumë detaje apo ngjarje, për të mos thënë botëkuptime që kanë shënuar fëmijërinë



e tij?

Vështirë për t'i dhënë përgjigje. Qëllimi që ato ditë të mesazheve sapo kisha mbaruar së lexuari një libër të mrekullueshëm, një lloj eseje filozofike të titulluar: "Identitete vrastare". Autori, një shkrimtar i njohur libanez, që në moshën 27-vjeçare ishte vendosur në Francë dhe që tashmë, prej po 27 vitesh, jetonte dhe krijonte atje, Amin Maalouf, shtronte pikërisht pyetjen më të thjeshtë, por edhe më të komplikuar në botë: "Cfarë jam unë?". Përgjigja e parë do të ishte pa dyshim e shpejtë dhe pa ndonjë refleksion të madh, libanez. Kishte lindur dhe ishte edukuar atje. Barthe me vete një pjesë të mentalitetit dhe kujtimeve të asaj pjesë të botës dhe, mbi të gjitha e mbi gjithçka, ishte mjaft i lidhur me historinë e vendit të tij. Por përgjigja e dytë dhe më e menduar kërkonte më shumë vëmendje. Prej 27 vitesh jetonte tashmë në Francë dhe jeta parisienne ishte bërë një shprehje e tij. Jetonte si francez, mendonte si francez, e mbi të gjitha shkruante frëngjisht. Ata që e takonin, e merrnin pa dyshim si të tillë dhe mënyra e të shprehurit dhe ajo të menduarit ishin aq larg bashkëdhëtarëve të tij. Akoma më shumë fëmijët e flisnin thjesht frëngjisht dhe Franca ishte atdheu i tyre i vetëm. E pra, çfarë ishte realisht ai dhe cila ishte përgjigja më e saktë që mund t'i jepte pyetjes së tij sfilite. I tunduar nga ideja e globalizimit, ai sqaronte apo linte të kuptohej se identitetet e kanë humbur tashmë kuptimin e tyre të parë e të dikurshëm dhe se ajo që konsiderohet si më e spikatura të një racë apo kombësi, nuk mund të jetë karakteristikë e të gjithë grupimit. Ideja se identitetet janë përzier tashmë dhe se të gjithëcili mund të flejë pak nga origjinat e largëta, dilte herë-herë në tekst,

duke shënuar një identitet të ri, por edhe shumë interesant, atë të njerëzve pa identitet të përcaktuar. Thjeshtë qytetarë të botës ose produkte të një globalizimi që sa vjen e rritet. Produktet të "Coca-Cola"-s apo "Philips"-it, të "Sony"-t apo "Gillette"-s, të "Versace"-s apo "Nestle". Qytetarë të një bote që sa po vjen e po unifikohet dhe ku dallimet karakteristike të dikurshme kanë mbetur shpesh si truke komerciale për të tunduar apo gënjyer turistët e hutuar.

Por nëse një pjesë e madhe e botës kishte filluar të bashkohen tashmë prej vitesh në këtë grupim gjithnjë e më rritje, në grupimin ku identitetet fillojnë e zbehen dhe nuk luajnë ndonjë rol të spikatur, nëse shumica e fëmijëve të botës kishin filluar prej dekadash të rriten dhe të edukohen në qytete dhe fshatra që gjithnjë e më shumë i ngjajnë njëri-tjetrit, pavarësisht cepave të globit ku janë ngritur, për në gjithçka ishte më e ndryshme. Jam i bindur se shumica e fëmijëve të botës sot, në momentin e ndërgjegjesimit të tyre kanë së paku një mori gjërash të njohura, pavarësisht vendit ku rriten: luajnë me topa që mbajnë markën "Adidas", ulen përballë tavolinash ku kanë prodhimet e "Nestle" dhe mbi to, shishet e "Pepsi" apo "Coca-Cola"-s. Fëmijët e mikut tim kishin pa dyshim një jetë si kjo, por jo ai vetë. I shënuar me një identitet të pastër dhe tashmë thajse të harruar, më shumë sesa produkt i globalizimit në rritje, ai dhe pothuajse të gjithë ne që qemë rritur para viteve '90 në Shqipëri, ruanim tashmë vullën e një origjine të spikatur. Një origjinë që na bën shpesh të ndihemi të afërt, por pse jo edhe të largët dhe të pakuqutëshëm për fëmijët që po rriten.

Nuk e di se sa të qartë e kisha


këtë vetë në kokë, por më shumë se kurrë e ndjeva një mbrëmje të mrekullueshme maji. Një mbrëmje të freskët buzë detit në Durrës, i tunduar nga ideja për të pjekur në një barbeky portative salsicet e një firme tiranase, të quajtur Hako, m'u desh të kaloj jo pak kohë me procesin e përgatitjes së saj. I pamësuar me zjarrin, besoj se shpenzojava jo pak kohë dhe një vandak me gazetë, për t'i dhënë flakë një turre drush të lagur; të cilat nga ana e tyre duhej të ndiznin dhe të përgatisnin disa grushte qymyr, mbi të cilat pritej të vendosej ushqimi që do të pijej. Nuk e di se sa kohë humba duke ndjekur me shqetësim flakën, që herë shfaqej e herë zbehej, por ndoshta rreth një orë pasi kisha hedhur shkrepësen e parë, flaka mori mbroth dhe unë vendosa të shtoja mbi të disa kaci qymyr, nga ai që shitet në çdo pikë shumice të Tiranës. Pak minuta më vonë, ndërsa qymyri kishte filluar të skuqej dhe të merrte formën përfundimtare të një barbekye, nuk e di pse aroma e tij, ajo erë e rëndë dhe shpesh e padurueshme, m'u bë befasi e afërt. Një ndjesi e çuditshme më solli pranë një nga ato ditët e ftohta të fëmijërisë ose më mirë të thuhet, një mbrëmje prej tyre. M'u kujtua se e rigjeta edhe një herë familjen time të mblodhur në kuzhinën e ngushtë, ku bubullinte një nga ato sobat 9 mijë lekëshe me dru, pa emër dhe markë, dhe që ne, si pothuajse gjithë shqiptarët e tjerë, e mbushnim shpesh në ditët e ftohta me qymyr. Duke shpresuar se nehtësia do të qëndronte më shumë dhe se, në fund të fundit, kjo ishte mënyra më e mirë për të kursyer diçka nga katër latat e druve, që vështirë se mund të ishin të mjaftueshme për një familje në një dimër të ashpër. Nuk e di pse rijetova edhe një herë momentin kur soba mbushej plot me atë qymyrin e keq dhe të lagësht

të Valiasit, i shndërruar në ca forma vezake dhe që nuk e di se përse quhej qymyrguri. Krejt inferior dhe i pakrahasueshëm me atë tjetrin, qymyrin e drurit apo qymyrin që mbante emrin "I Memaliajit". Një asocim i çuditshëm e lidhi erën e qymyrit me atë të çajit të malit, që ziente në cep të sobës, në çajnikun kinez prej alumini, dhe që, sa herë nxehej tej normales, prodhonte një shfryrje të zhurmshme dhe pse jo të frikshme. Pastaj vinte era e bukës së thekur, nganjëherë të djegur, që jo rrallë, për t'i shmangur kontaktin me pllakën e nxehtë të sobës, e vendosnim mbi mashën e gjatë. I tunduar nga ai kujtim i mrekullueshëm, por njëkohësisht i mjerë i fëmijërisë, nuk e di pse m'u duk vetja krejt absurd përpara barbekyës portative, qymyrit që e merrja tashmë nga një thes me etiketë të shkruar bukur dhe salsicëve, që prisnin në krah shndërrimin e qymyrit në prush. I gjendur mes dy situatave, që aq papritur dhe pabesueshëm i kishte lidhur një aromë e rëndë dhe aspak e këndshme qymyri, mendova befasi se një asocim të ngjashëm duhej të kishin me qindra mijëra, në mos me miliona shqiptarë të tjerë. A ka ndonjë prej tyre, pyeta veten, që nuk bashkon dot në një aromën e bukës së thekur në sobë dhe jo në thekësen elektrike, erën e çajit të malit, që del nga një çajnik i përvëlur alumini dhe aromën e qymyrit, që prodhonte shpesh në kuzhinat e vogla një ajër të rëndë dhe mbytet? Vështirë, ia ktheva përgjigjen vetes dhe nuk e di pse besova atë moment se ajo që na shënjonte të gjithëve dhe që na bënte kaq të afërt me njëri-tjetrin, ishte pikërisht kjo. Ose disa dhjetëra situata e detaje të tilla, krejtësisht tonat, që kishin shënuar një pjesë të rëndësishme të jetës ose formimit shqiptar. Dhe që ishin kaq të veçanta dhe kaq të ndryshme nga çdo situatë ose detaj që kishte shënuar formimin e një populli ose disa popujve në të njëjtën epokë me atë tonën.

Disa orë më vonë, ndërsa darka kishte mbaruar dhe mbi barbekyën portative qemë fikur tashmë edhe thëngjijtë e fundit, telekomanda e televizorit më mbeti padashur në një stacion që transmetonte, nuk e di se si, një emision homazh për Tano Banushin. Një emision i mrekullueshëm, që risillte pranë humorin e hollë të shumë viteve më parë, që ishte, as më shumë dhe as më pak, humori i fëmijërisë sime. M'u kujtua se si ngulesha para TVSH-së ditën e shtunë në mbrëmje, kur sipas programit të saj ishte "Estrada në ekran" dhe m'u duk se ende tani e kam të vështirë të përjetoj po atë kënaqësi të atyre dy orëve. A mund t'ia shpjegojem mik u m'u fëmijëve të tij amerikane këtë dhe a do ta kuptonin ata? Si do t'ua shpjegonte atë momentin kur i veshur si fotograf, Tano Banushi replikon me qytetarin që nuk gjente fotografinë e tij, duke i lëshuar batutën monumentale: "Gruan ta gjeta, fëmijët t'i gjeta, kur nuk e di të ti vetë ku je, si ta di unë!" Pa dyshim që nuk do ta kuptonin dhe nuk është çudi që, në një moment apo në një tjetër, ta vështronin me qortim. Qenë të aftë të kuptonin që njëri, në çdo cep të globit, por jo babain e tyre të rritur në një lagje të ulët dhe me qerpic të Tiranës. I përkisnin një grupi tjetër identitetesh dhe, ashtu si në një tregim të mrekullueshëm të Teodor Kekos, vetëm më vonë do ta kuptonin se i ati, miqtë e tij, shumë nga ne, i përkisnin një identiteti dikur të spikatur, por tani në zhdukje, atij të shënuar me firmën e dikurshme: "made in Albania".

Marrë nga revista "MEDIJA"

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Riza aktor.
- Një fjalë si hijç.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtom të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Qe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka bërë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.
- Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triplet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

VERTIKAL

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstremit në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë illogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprind hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rrallë.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsërite.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.
- Nuk shuhej dot nga Tantalit.

VERTIKAL


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinas.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëllot për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rrallë është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



- Të gjitha gjërat e mëdha janë të thjeshta dhe shumë mund të shprehen me një fjalë të vetme: liri, drejtësi, nder, detyrë, mëshirë dhe shpresë.

- Edhe pse personalisht jam shumë i kënaqur me eksplozivët e momentin, e ndjej se s'duhet të qëndrojmë në rrugën e përmirësimit.

-Edhe pse i përgatitur për mundimet, preferoj që të shtyhen.

-Qëndrimi është diçka e vogël, por që bën një ndryshim të madh.

-Baldwin mendonte se Evropa ishte e mërzitshme, dhe Chamberlain mendonte se ishte vetëm më i madh se Birminghami.

Thënie të mënçura

-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

- -Betejat fitohen nga kërcia dhe manovrat. Sa më i madh gjenerali, aq më shumë do të kontribuojë në manovrat, aq më pak do të kërkojë për kërci.
- -Para Alamein-it nuk kemi pasur kurrë një fitorë.
- - Pasi Alamein-it kurrë nuk kemi patur humbje.
- - Fjalët e shkurtra janë më të mirat, dhe fjalët e vjetra janë edhe më të mira.

- -Përpjekjet e vazhdueshme, jo forca apo inteligjenca, janë sekret i çlirimit të potencialit tonë.
- -Kuraja vlerësohet me të drejtë cilësi e parë e njeriut, sepse është cilësia që i garanton gjithë të tjerat.

SUDOKU

		1	4	9	7				
				8					7
					3				
	2			5	8				
5		6	2		1	3			
4	9			7		5			
	3			1					8
				6	2	4	5		
6									1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	4	6	5	8	2	7	3
2	5	7	4	3	9	6	1	8
3	8	6	2	1	7	5	4	9
4	1	2	5	8	3	7	9	6
7	3	9	1	2	6	8	5	4
5	6	8	7	9	4	3	2	1
9	2	5	3	6	1	4	8	7
6	4	1	8	7	5	9	3	2
8	7	3	9	4	2	1	6	5

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2
	1	12	4	2	12	4	11	6	1	8		
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2	
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12
3			5	10	3	1	14	4	6	1		
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3
7	10	6	10	14	4	8		12	10	7	4	
12	11	1		9	4		12	6	8	15	8	
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14
7	2	14	2	12		7	10	9	13	15	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12

- -Përpjekjet e vazhdueshme, jo forca apo inteligjenca, janë sekret i çlirimit të potencialit tonë.
- -Kuraja vlerësohet me të drejtë cilësi e parë e njeriut, sepse është cilësia që i garanton gjithë të tjerat.

